



Ministri Vengu viziton Kosovën: Shqipëria, avokate e fortë për anëtarësimin e Kosovës në organizmat ndërkombëtare



Ministri Vengu vizitoi Komandën e KFOR-it dhe kontingjentin e forcave shqiptare në Pejë. Gjatë vizitës zyrtare në Kosovë, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu u ndal edhe në Komandën Qendrore të KFOR-it, si dhe në Komandën e Zonës Perëndimore në Pejë, ku takoi trupat shqiptare, që shërbejnë përkrah vendeve aleate dhe partnere të NATO-s.

I shoqëruar nga ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Petrit Malaj, ministri i Mbrojtjes u prit nga komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutaş, me të cilin ndanë shqetësimin rreth kontekstit të brishtë të sigurisë, kryesisht në veri të Kosovës, duke kujtuar sulmet kriminale dhe terroriste ndaj trupave të KFOR-it si edhe atë në Banjskë, vitin e kaluar: “Shqipëria mbështet pa asnjë lëkundje KFOR-in, si të vetmen garanci për një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm në Kosovë”, - u shpreh Vengu, duke falënderuar gjeneralmajor Ulutaş për vendosmërinë dhe maturinë në parandalimin e situatave kërcënuese.

Në bazën e KFOR-it në Pejë, delegacioni shqiptar u prit nga komandanti italian i bazës, koloneli Mundo, i cili e informoi zotin Vengu për kontributin e trupave shqiptare, duke theksuar se angazhimi dhe profesionalizmi i tyre vlerësohet nga të gjithë shtetasit e Kosovës dhe veçanërisht nga minoritetet.

Në takimin me kontingjentin shqiptar, ministri Vengu falënderoi gratë dhe burrat e Forcave tona të Armatosura që shërbejnë në misionin e KFOR, i cili ka për qëllim sigurinë e të gjithë popullsisë dhe lirinë e lëvizjes në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Rritja e kontributeve të Shqipërisë në misionet e NATO-s, kërkon gjithashtu një vëmendje më të madhe ndaj përmirësimit të kushteve në mision të forcave tona dhe mbështetje të vazhdueshme për familjet e tyre.

Kontingjenti shqiptar në misionin e KFOR-it është rritur së fundmi dhe përbëhet nga 107 efektivë në Komandën Rajonale Perëndimore në Pejë dhe 25 përfaqësues civilë dhe ushtarakë në Shtabin e KFOR-it në Film City, Prishtinë.



Ministri Vengu viziton Komandën e KFOR-it dhe kontingjentin e forcave shqiptare në Pejë



INDUSTRIA USHTARAKE

290 milionë lekë për detyrimet e prapambetura
150 milionë lekë për themelimin e KAYO sh.a

Rijetësimi i industrisë ushtarake, zhvillim social-ekonomik, siguri kombëtare

Akti normativ i Këshillit të Ministrave injekton 440 milionë lekë në fazën e parë të projektit për rijetësimin e industrisë ushtarake. Konkretisht, janë alokuar 290 milionë lekë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të uzinave të industrisë ushtarake ndaj punonjësve, ish-punonjësve, bashkive dhe enteve të tjera. 150 milionë lekë janë dedikuar për themelimin e shoqërisë tregtare “KAYO Sh.a”, e cila do të udhëheqë procesin e modernizimit të industrisë ushtarake dhe rijetësimin e kapaciteteve prodhuese të Mjekësit, Gramshit dhe Poliçanit. Rijetësimi i industrisë ushtarake është një mundësi e re për zhvillimin ekonomik dhe social të zonave të përfshira në këto projekte, por edhe shumë i rëndësishëm për integrimin e vendit në hallkat e prodhimit dhe logjistikës ndërkombëtare. Projekti i qeverisë shqiptare për modernizimin e sektorit, kontribuon gjithashtu në forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare në përputhje me objektivat e Aleancës.

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, vizitën e tij të parë zyrtare jashtë vendit e zhvilloi në Kosovë. Fillimisht ministri Vengu takoi kryeministrin e Kosovës, z. Albin Kurti, ku gjatë takimit theksi u vendos tek forcimi i bashkëpunimit në rrafshin e Mbrojtjes, stabilitetin rajonal dhe ndërveprimin e domosdoshëm me aleatët për një konsolidim të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës.

Ministri Vengu po ashtu zhvilloi edhe një takim me homologun e tij Ejup Maqedonci, ku vlerësoi pa masë bashkëpunimin e shkëlqyer dhe vëllazëror midis dy vendeve dhe theksoi se bashkëpunimi me Kosovën konsiderohet strategjik, stabilizues për rajonin dhe orientues për perspektivën euroatlantike.

Ministri Vengu rikonfirmoi se, Kosova vijon të jetë prioritet absolut i Shqipërisë dhe si rrjedhojë prioritet parësor i Ministrisë së Mbrojtjes, e cila ka qenë gjithmonë në krah dhe në mbështetje të zhvillimit të Forcave të Sigurisë së Kosovës. Sa i takon anëtarësimit të Kosovës në organizmat ndërkombëtare, ministri Vengu siguroi se Shqipëria do të jetë një avokate e fortë e saj: “Viti 2024, rezultoi të jetë një vit shumë impenjativ për Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë, pasi këtë vit kemi kryesimin e disa iniciativave rajonale dhe shumë aktivitete në kuadër të tyre do të drejtohen dhe organizohen nga ana jonë (A5). Unë siguroj kolegun Maqedonci, se kjo mundësi do shfrytëzohet maksimalisht jo vetëm për të qenë një avokate e fortë e Kosovës, por për të shtuar të gjitha përpjekjet për një anëtarësim të plotë të saj në këto iniciativa.”

Gjatë takimit u diskutua edhe për thellimin e bashkëpunimit në fushat e çminimit të brezit kufitar ndërmjet dy vendeve si dhe dhënien e asistencës së nevojshme për konsolidimin e mëtejshëm të Qendrës Rajonale për Emergjencat Civile.

Situata e sigurisë dhe mbrojtjes në rajonin e Ballkanit Perëndimor me fokus kryesor, situatën aktuale në Kosovë ishte një tjetër pikë e rëndësishme e takimit: “Vlerësojmë se dialogu Kosovë - Serbi, në koordinim me partnerët strategjikë të Kosovës, SHBA dhe BE duhet të ketë si rezultat përfundimtar një marrëveshje të detyrueshme ligjore, që mundëson njohjen e ndërsjellët mes dy vendeve, anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe BE, si dhe trajtim të drejtë të minoriteteve, konform Kushtetutës së Kosovës”, - tha ministri Vengu, i cili vlerësoi z. Macedonci për mikpritjen.

Ministri Vengu: Sa i takon anëtarësimit të Kosovës në organizmat ndërkombëtare, Shqipëria do të jetë një avokate e fortë e saj



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji mbledhi në ambientet e Shtabit të Përgjithshëm, në shenjë mirënjohje dhe falënderimi për përkushtimin dhe punën e palodhur, kolonelët, të cilët mbyllën me nder qëndrimin e tyre në këtë gradë, sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

Gjeneralmajor Kingji në ceremoninë e organizuar me këtë rast për kolonel Agim Shahun, kolonel Arben Dhulin, kolonel Ardian Lulajn, kolonel Dilaver Hoxhën, kolonel Isuf Hamatin, kolonel Roland Berzanin dhe kapitenin e rangut I Ëngjëll Sinanaj, shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e tij dhe gjithë komunitetit të Forcave të Armatosura, për profesionalizmin, sakrificën dhe përkushtimin në këtë rrugëtim të gjatë nën uniformë, duke e përmbushur me sukses misionin ndaj detyrës dhe Atdheut.

Më tej ai u uroi shëndet, mbarësi dhe suksese të mëtejshme në jetën civile. “Faleminderit për shërbimin tuaj!”, - mbylli fjalën e tij gjeneralmajor Kingji.





Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Xhebexhia pret delegacionin e Gardës Kombëtare të FSK-së

Në kuadër të bashkëpunimit ushtarak ndërmjet FARSH-së dhe FSK-së, delegacioni i Gardës Kombëtare të FSK-së, zhvilloi sot një vizitë kortezie në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore. Delegacioni i kryesuar nga komandanti i Gardës Kombëtare të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri u prit në takim nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Ilir Xhebexhia. Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia pasi u uroi mirëseardhjen delegacionit Kosovar u shpreh në domosdoshmërinë e rritjes së bashkëpunimit mes Forcës Tokësore dhe Gardës Kombëtare të FSK-së, si në fushën e arsimit ashtu edhe në zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta.

Në fjalën e tij, komandanti i Gardës Kombëtare të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri, pasi falënderoi gjeneralmajor Ilir Xhebexhian për mikpritjen, theksoi domosdoshmërinë për rritjen e bashkëpunimit dhe trajnimeve dypalëshe për t'u përballur me sfidat dhe situatat të cilat vijnë në rritje.

Të pranishmit në takim ndër të tjera diskutuan në lidhje me realizimin e vizitave e takimeve të përbashkëta, për njohjen më nga afër me strukturat dhe aktivitetet e përditshme që ato realizojnë. Në përfundim të takimit ndërmjet komandantit të Gardës Kombëtare



të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri dhe komandantit të Forcës Tokësore gjeneralmajor Ilir Xhebexhia u shkëmbyen dhuratat simbolike dhe u realizua foto e përbashkët.

Forca Tokësore nis kontingjentin KFOR-6 në kuadër të misionit KFOR, Pejë, Kosovë

Në mjediset e Forcës Tokësore, u zhvillua ceremonia e përcjelljes së trupave nga Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë (bkl), të cilët do të shërbejnë në KFOR, si pjesë e misionit të NATO-s, në Pejë, Kosovë.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, morën pjesë: komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Altin Kurti, shefi i Shtabit të Forcës Tokësore, kolonel Ilirjan Dauti, shefa nga shtabi i FT-së dhe i bkl-së etj.

Fjala e hapjes u mbajt nga komandanti i bkl-së, kolonel Xhevair Kërzhalliu, i cili ndër të tjera vuri theksin tek eksperiencia e krijuar ndër vite nga efektivet e batalionit në operacione paqeruajtëse. Është kjo eksperiencë, por edhe trajnimi i vijueshëm që kryhet në këtë repart, ato që e mbushin me besim se ky mision do të jetë i suksesshëm, ashtu si edhe misionet paraardhëse.

Duke marrë fjalën në ceremoni, komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Xhebexhia, pasi i uroi ushtarakëve pjesëmarrës suksese në mision theksoi: "... Ju jeni ambasadorët e paqes dhe si të tillë duhet të kryeni të gjitha detyrat me përkushtim dhe profesionalizëm sa më të lartë, duke treguar vlerat tuaja dhe të Forcës që përfaqësoni...". Në mbyllje të fjalës së tij, gjeneralmajor Xhebexhia i siguroi pjesëmarrësit e kontingjentit "KFOR-6" me mision në Kosovë, se Forca Tokësore, por



edhe Shtabi i Përgjithshëm e Ministria e Mbrojtjes do të jenë gjithmonë në kontakt me ta dhe pranë tyre, për çdo problem apo nevojë që do të kenë. Të pranishmit, i përshëndeti në emër të kontingjentit, komandanti i kontingjentit kapiten Saimir Sheme, i



Firmoset marrëveshja për digjitalizimin e procesit mësimor mes AFA-së dhe RASH-së

Digjitalizimi i procesit mësimor në Akademinë e Forcave të Armatosura ishte në fokusin e takimit të gjeneralit dhe rektorit të AFA-së, Bardhyl Nuredinaj me dr. Arjan Xhelajn, drejtor të RASH-së.

Procesi u finalizua me firmosjen e marrëveshjes së bashkëpunimit për digjitalizimin e procesit mësimor nëpërmjet shërbimeve TIK, të ofruara nga RASH dhe lidhjen me rrjetin GÉANT Community.

Synimi kryesor është përmirësimi i procesit mësimor në mbështetje të studentëve dhe personelit akademik.

AFA do të vijojë me punën për transformim, duke ofruar arsim cilësor dhe bashkëkohor me punësim dhe karrierë të sigurt brenda FARSH-së.



cili pasi falënderoi eprorët për besimin e treguar i siguroi ata se misionin që ju është ngarkuar, do ta kryejnë me devotshmëri dhe profesionalizëm. Me nisjen e këtij kontingjenti, Forca Tokësore shton kontributet e saj në interes të paqes dhe sigurisë rajonale.

Komanda Mbështetëse priti Komandantin e Gardës Kombëtare të FSK, gjeneral brigade Naim Haziri

Në kuadër të bashkëpunimit ushtarak ndërmjet FARSH-së dhe FSK-së, delegacioni i Gardës Kombëtare të FSK-së, zhvilloi një vizitë njohëse në ambientet e Komandës Mbështetëse.

Delegacioni i kryesuar nga komandanti i Gardës Kombëtare të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri u prit në takim nga zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela. Zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse shprehu falënderime për bashkëpunimin e kahershëm në fushën e arsimit dhe kualifikimit institucional, profesional si dhe për stërvitjet dypalëshe. Vizita njohëse e delegacionit vijoi me zhvillimin e një brifingu, ku të pranishmit u prezantuan me historikun, strukturën, misionin, detyrat, operacionet e kryera nga Komanda Mbështetëse në mbështetje të emergjencave civile në rast zjarri, përmbytje, operacionet e ndryshme EOD.



Në fjalën e tij të radhës, komandanti i Gardës Kombëtare të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri falënderoi zëvendëskomandantin e Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela për ftesën dhe theksoi domosdoshmërinë për rritjen e



bashkëpunimit, ndërveprimit, dhe trajnimeve dypalëshe për t'u përballur me sfidat dhe situatat e emergjencave civile të cilat vijnë në rritje. Të pranishmit në takim ndër të tjera diskutuan në lidhje me realizimin e vizitave e takimeve të përbashkëta, për njohjen më nga afër me strukturat dhe aktivitetet e përditshme

që ato realizojnë. Në përfundim të takimit ndërmjet komandantit të Gardës Kombëtare të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri dhe zëvendëskomandantit të Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela u shkëmbyen dhuratat simbolike dhe u realizua foto e përbashkët.

Vizitë kortezie e Atasheut Ushtarak Francez i akredituar në vendin tonë, kolonel Valery Sens, në Komandën e FAj

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, priti në një takim kortezie atasheun ushtarak Francez i akredituar në vendin tonë, Kolonel Valery Sens.

Gjeneral Dimo, pasi e uroi kolonelin Sens për detyrën e re të atasheut ushtarak të Francës, e njohu atë me prioritetet dhe ecurinë e operacionalitetit të mjeteve ajrore. Gjatë takimit u diskutua mbi rritjen e bashkëpunimit me kompaninë AIRBUS, kryesisht në drejtim të trajnimit të pilotëve dhe personelit teknik të helikopterëve “Cougar”, në funksion të rritjes së gatishmërisë operacionale të tyre. Në përfundim të takimit, gjeneral Dimo, falënderoi atasheun për vizitën e tij në Komandën e Forcës Ajrore, duke e siguruar se bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen.



Helikopteri AS532AL “Cougar” ulet në Rinas, i gatshëm për operacione

Helikopteri tip AS532AL “Cougar” me numër FA634 është ulur në Aeroportin e Rinasit dhe është në gatishmëri operacionale. Helikopteri kreu punimet e thella të mirëmbajtjes pranë kompanisë RUAG në Zvicër, falë bashkëpunimit me NSPA (Agjencinë e Prokurimeve të NATO-s), me të cilën jemi në rrugën e duhur për të rikthyer progresivisht gatishmërinë teknike të të gjithë Flotës sonë Ajrore.

Fluturimi i kontrollit teknik dhe i marrjes në dorëzim (Acceptance Test Flight) është kryer me personelin pilot dhe teknik të Forcës Ajrore shqiptare në bord.





KOLONEL ARBEN DHULI

Vitet 1980 shënuan një pikë kthese për termin “logjistikë e integruar”, duke theksuar nevojën për një perspektivë holistike që integron të gjitha funksionet e logjistikës për të rritur efikasitetin dhe konkurrencën. Me futjen e teknologjisë së informacionit në vitet 1990, ajo fitoi edhe më shumë vull nëpërmjet analizave moderne në kohë reale dhe sistemeve të menaxhimit të të dhënave. Në shekullin e 21-të, logjistika e integruar është bërë një pjesë e rëndësishme e strategjisë së biznesit, e njohur për aftësinë e saj për të ulur kostot, për të përmirësuar kënaqësinë e klientëve dhe për të forcuar konkurrencën. I zhvilluar fillimisht për qëllime ushtarake, MIL tani përdoret gjerësisht edhe në organizatat komerciale të shërbimit ndaj klientit. Qëllimi kryesor i MIL është të krijojë sisteme që zgjasin më shumë, kërkojnë më pak mbështetje dhe në fund të zvogëlojnë kostot, duke rritur kthimin e investimeve.


Në këtë artikull, ne hedhim një vështrim më të afërt se çfarë do të thotë logjistika e integruar, si ndryshon nga logjistika tradicionale dhe se si zbatimi i suksesshëm mund t’i ndihmojë kompanitë të kenë sukses në një mjedis kompleks dhe dinamik biznesi. Ai përfshin aspekte të ndryshme të mbështetjes, jo vetëm gjatë blerjes, por edhe gjatë gjithë ciklit të jetës operacionale të sistemit. Elementet kryesore të MIL përfshijnë inxhinierinë e besueshmërisë, planifikimin e mirëmbajtjes, mbështetjen e furnizimit, fuqinë punëtore dhe personelin, trajnimin, të dhënat teknike dhe më shumë. Duke integruar këto disiplina, MIL synon të optimizojë mbështetjen e produktit dhe të ulë kërkesën për logjistikë.

Mbështetja e integruar e logjistike (MIL) është planifikimi dhe veprimi i integruar i një numri disiplinash në bashkëpunim me njëra-tjetrën për të siguruar disponueshmërinë e sistemit. Planifikimi i secilit element të MIL zhvillohet në mënyrë ideale në koordinim me përpjekjet inxhinierike të sistemit dhe me njëri-tjetrin. Mund të kërkohej shkëmbime ndërmjet elementeve, në mënyrë që të fitohet një sistem që është: i përballueshëm (kostoja më e ulët e ciklit jetësor), i funksionueshëm, i mbështetur, i qëndrueshëm, i transportueshëm dhe i shëndoshë mjedisor. Në disa raste, një proces i qëllimshëm i Analizës së Mbështetjes Logjistike do të përdoret për të identifikuar detyrat brenda çdo elementi të saj. Mbështetja e Integruar Logjistike, ose shkurt MIL, është një strategji menaxhimi për planifikimin dhe zhvillimin e mbështetjes efikase për sistemet gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor. MIL mund të aplikohet në çdo moment gjatë zhvillimit të një produkti ose sistemi. Mbështetja e Integruar Logjistike (MIL) ndryshon nga mbështetja tradicionale logjistike në disa drejtime kryesore si, qasja holistike: Ku sistemet trajtohen si tërësi koherente, pjesët përbërëse të të cilave kuptohen më mirë në kontekst dhe në lidhje si me njëri-tjetrin ashtu edhe me të tërën. MIL merr një qasje gjithëpërfshirëse, duke marrë parasysh të gjithë ciklin e jetës së një sistemi ose produkti. Ai mbulon fazat e planifikimit, blerjes, funksionimit dhe asgjësimit. Ndërsa Logjistika tradicionale, shpesh fokusohet në aspekte specifike (p.sh, transporti, menaxhimi i inventarit) pa marrë parasysh kontekstin më të gjerë. MIL integron disiplina të ndryshme, duke përfshirë inxhinierinë e besueshmërisë, mirëmbajtjen, menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, trajnimin dhe të dhënat teknike. MIL i jep përparësi mbështetjes gjatë gjithë jetës së sistemit. Ai synon të minimizojë kohën e ndërprerjes, të rrisë besueshmërinë dhe të reduktojë kostot e mirëmbajtjes. Ndërsa Logjistika tradicionale, mund t’i japë përparësi kursimeve të kostos pa theksuar mbështetjen afatgjatë. Reduktimi afatgjatë i kostos: MIL synon të reduktojë kostot e përgjithshme të ciklit jetësor, duke optimizuar proceset mbështetëse. Ndërsa Logjistika tradicionale, mund të fokusohet më shumë në kursimet afatshkurtra të kostos. Në përmbledhje, MIL ofron një qasje holistike dhe të integruar për mbështetjen logjistike, duke theksuar efikasitetin dhe efektivitetin afatgjatë. Ndërsa Logjistika tradicionale priret të jetë më e fragmentuar dhe reaktive. Po japim disa shembuj të Mbështetjes së Integruar të Logjistikës (MIL) ato janë: Menaxhimi i inventarit vetëm në kohë, një strategji që minimizon nivelet e inventarit, duke ofruar materiale ose pjesë saktësisht kur nevojiten, duke reduktuar kostot e magazinimit dhe mbetjet. Sistemet e gjurmimit në kohë reale: Zbatimi i teknologjive si ajo GPS për të monitoruar lëvizjen e mallrave, automjeteve ose aseteve në kohë reale. Menaxhimi efikas i magazinës: Optimizimi i paraqitjes së magazinës, vendosja e inventarit dhe proceset e përmbushjes së porosive për të rritur efikasitetin dhe për të ulur kostot. Bashkëpunimi me Furnizuesit: Koordinim i ngushtë me furnitorët për të siguruar dërgesat në kohë, kontrollin e cilësisë dhe burimet me kosto efektive. Optimizimi i rrugëve të shpërndarjes: Përdorimi i analitikës së të dhënave dhe softuerit të planifikimit të rrugës për të minimizuar kohën e transportit, konsumin e karburantit dhe vonesat e dorëzimit. Përdorimi i teknologjive të informacionit: Përdorimi i sistemeve softuerike për menaxhimin e inventarit, përpunimin e porosive dhe dukshmërinë e zinxhirit të furnizimit. Riciklimi dhe paketimi i qëndrueshëm: Përfshirja e praktikave miqësore me mjedisin në logjistikë, të tilla si riciklimi i materialeve dhe përdorimi i paketimeve të ndërgjegjshme për mjedisin.

Trajnimi i vazhdueshëm i personelit: Sigurimi që stafi i logjistikës të marrë trajnime të vazhdueshme për të qëndruar i përditësuar mbi praktikatat më të mira dhe teknologjitë e reja.

Logjistika e integruar, u shfaq si një paradigmë revolucionare në menaxhimin e biznesit, ka pësuar një zhvillim të jashtëzakonshëm që nga shfaqja e saj e parë në vitet 1950. Fillimisht e fokusuar në logjistikë dhe transport, globalizimi dhe kompleksiteti i


Mbështetja e integruar logjistike



zinxhirëve të furnizimit kanë çuar në një tranzicion të qartë drejt një strategjie të integruar.

Përkufizimi i logjistikës së integruar si një qasje gjithëpërfshirëse për menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, nga prokurimi i lëndëve të para deri te dorëzimi përfundimtar i produkteve te klientët. Të gjithë elementët logjistikë, duke përfshirë transportin, magazinimin, përmbushjen dhe shpërndarjen, janë të koordinuara në mënyrë efikase, duke siguruar qetësi dhe efikasitet në çdo fazë të procesit.

Ndërsa logjistika tradicionale fokusohet në detyra specifike, të grimcuara, të tilla si transporti ose magazinimi, logjistika e integruar përfshin një qasje holistike. Një qasje holistike merr në konsideratë të gjithë personin, jo vetëm nevojat e tij për shëndetin mendor. Ai gjithashtu merr parasysh mirëqenien e tyre fizike, emocionale, sociale dhe shpirtërore. Në psikologji, holizmi thekson të kuptuarit e të gjithë personit ose sistemit në vend që të fokusohet vetëm në pjesë ose përbërës individualë. Dëgjimi, pyetja dhe kontrollimi janë aftësi kyçe kur ofrohet mbështetje gjithëpërfshirëse, duke ditur se përvoja e çdo personi është unike dhe e ndikuar nga faktorë të ndryshëm si mosha, kultura dhe



besimet. që kërkon të integrojë dhe optimizojë të gjitha aktivitetet.

Logjistika e integruar, nga ana tjetër, merr një perspektivë afatgjatë dhe pranon se të gjitha funksionet e logjistikës duhet të koordinohen për të përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm. Fokus i ndaj klientit është një tjetër diferencues. Ndërsa logjistika tradicionale fokusohet më shumë në uljen e kostove operative, logjistika e integruar shkon më tej duke i dhënë përparësi përmirësimit të vazhdueshëm të përvojës së klientit. Në praktikë, logjistika e integruar përfshin bashkëpunim të ngushtë midis departamenteve të ndryshme brenda një kompanie dhe futjen e teknologjive të avancuara. Çelësi është të pranohet se çdo element i zinxhirit të furnizimit është i ndërlidhur dhe se përmirësimi i tij do të ketë një ndikim pozitiv në performancën e përgjithshme. Si përfundim, ndryshimi i rëndësishëm midis logjistikës dhe logjistikës së integruar qëndron në qasjen dhe filozofinë e tyre.

Llogjistika e integruar përqendrohet në fleksibilitet, duke u mundësuar kompanive të përshtaten shpejt me ndryshimet në kërkesën e tregut, duke shmangur rezervat e tepërta ose stoqet.

Bashkëpunimi i brendshëm dhe i jashtëm: nxitja e bashkëpunimit të ngushtë me partnerë të jashtëm në të gjitha departamentet e kompanisë dhe në të gjithë zinxhirin e furnizimit për të promovuar komunikim efektiv dhe vendimmarrje të përbashkët.

Qëndrueshmëria: minimizon ndikimin mjedisor të zinxhirit të furnizimit, duke përfshirë, duke marrë parasysh praktikatat e qëndrueshme të logjistikës.

Përmirësimi i vazhdueshëm: logjistika e integruar përqipet të zbatojë një proces përmirësimi, duke vlerësuar vazhdimisht operacionet dhe duke zbatuar rregullime për të ruajtur efikasitetin afatgjatë.

Integrimi efektiv i logjistikës së integruar në një kompani përfshin bashkëpunim të ngushtë midis të gjitha departamenteve që lidhen me zinxhirin e furnizimit. Zbatimi i teknologjive të avancuara të informacionit, të tilla si softueri i logjistikës, sistemet e menaxhimit të depove dhe softueri TMS, është thelbësor për të koordinuar në mënyrë efikase operacionet. Përveç kësaj,

trajnimi i stafit dhe përafrimi i objektivave të biznesit me strategjitë e logjistikës janë thelbësore për sukses.

Shembuj të logjistikës së integruar

Logjistika e integruar manifestohet konkretisht përmes praktikave dhe strategjive të ndryshme të zbatuara nga kompanitë vizionare. Disa shembuj të shquar të logjistikës së integruar përfshijnë: Menaxhimi i inventarit në kohë; Sistemet e gjurmimit në kohë reale; Menaxhimi efikas i magazinës; Bashkëpunimi me furnitorët; Optimizimi i rrugëve të shpërndarjes; Përdorimi i teknologjive të informacionit; Riciklimi dhe paketimi i qëndrueshëm; Trajnimi i

vazhdueshëm i personelit. Këta shembuj ilustrojnë sesi logjistika e integruar nuk është vetëm një teori strategjike, por një realitet operacional që drejton suksesin e kompanive të ndryshme në industri të ndryshme. Zbatimi efektiv i këtyre qasjeve tregon aftësinë e logjistikës së integruar për të përmirësuar efikasitetin, për të ulur kostot dhe për të forcuar pozicionin konkurrues në treg.

Kompanitë e logjistikës gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në këtë skenar dhe kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të logjistikës së integruar. Logjistika integrale jo vetëm që luan një rol vendimtar në mjedisin e sotëm të biznesit, por rëndësia e saj do të vazhdojë të rritet në mënyrë të qëndrueshme në të ardhmen.

Shmang dështimet e kushtueshme në produktet vitale, të shtrenjta dhe që kërkojnë kohë. Evolucioni i logjistikës së integruar, e ndikuar nga aftësitë teknologjike të kërkesave të sistemit dhe mjedisi kompleks në të cilin funksionojnë këto sisteme. Ruajtja e të dhënave, komunikimi dhe teknologjia e informacionit (IT) kanë parë të gjitha rritje teknologjike në kapacitet. Sasia e dokumentacionit të prodhuar në një mjedis inxhinierik do të mbushte ngarkesat e kamionëve nëse printohej. Për fat të mirë, në ditët e sotme, këto dokumente mund të ruhen në mënyrë elektronike.

Shërbimet për Mbështetjen e Integruar të Logjistikës ofrojnë shërbime logjistike që optimizojnë pajisjet dhe gatishmërinë e sistemit gjatë gjithë jetës së tyre të shërbimit, duke përfshirë rialokimin e aseteve mbështetëse për sistemet dhe teknologjitë e vendosura gjerësisht. Shërbimet i përmbahen direktivave qeveritare dhe ushtarake, si dhe standardeve të vendosura të industrisë, me theks në mirëmbajtjen dhe mbështetjen e pajisjeve. Një mënyrë për të menduar për këtë proces është si një proces i vazhdueshëm përmirësimi. Kjo do të thotë se çdo detaj do të shqyrtohet dhe rregullohet mirë për të maksimizuar funksionalitetin. Kjo mund të arrihet nëpërmjet përdorimit të mjeteve të tilla si mirëmbajtja rutinë, përmirësimet, riparimet, kurset e trajnimit dhe testet. Pas testimit, krijohet një raport që përshkruan rekomandimet për ndryshim ose përmirësim. Ai do të identifikojë gabimet e njohura që ndërhyjnë në efikasitetin operacional, ngadalësojnë proceset dhe shkaktojnë pakënaqësi të punonjësve dhe menaxhmentit.

Dy mënyra të zakonshme janë testimi psikometrik dhe/ose i aftësisë. Këto do t’ju ndihmojnë të përcaktoni personalitetin, aftësitë dhe talentet e një punonjësi. Më pas, menaxhmenti mund ta përdorë këtë informacion për të caktuar individët në role bazuar në rezultatet e këtyre vlerësimeve. Kjo është metoda më e shpejtë dhe më e drejtpërdrejtë për të zbuluar një përputhje të përsosur midis të dyjave. Modulet e reja të trajnimit të punonjësve janë zhvilluar për t’i pajisur ata me teorinë dhe aftësitë praktike që u nevojiten për të pasur sukses në punët e tyre.

Është thelbësore në MIL që të ketë funksionim optimal të sistemit, i cili mund të arrihet nëpërmjet një plani të rregullt të përditësimit, mirëmbajtjes dhe riparimit. Zbatimi i strategjisë për blerjen/prodhimin e ri të materialit ofron mundësinë për të maksimizuar ndikimin e dobishëm të elementeve jo vetëm gjatë fazës së blerjes, por gjatë gjithë ciklit të jetës së tij operacionale. Mbështetja Logjistike e blerjes ka përvojë/ekspertizë në kryerjen e mbështetjes logjistike në faza të ndryshme të procesit të blerjes. Ajo përdor Kornizën e Përvetësimit të Mbrojtjes të përshkruar si një udhëzues për menaxhimin e programeve të blerjes së sistemit. Pra Logjistika e Blerjes sqaron qartë se blerja para sistemit ka në vetvete si fazë të parë përzgjedhjen e Materialeve (faza e Analizimit), faza e zhvillimit teknologjik, e gjitha kjo mbyllet me blerjen para sistemit, ndërsa Sistemi i blerjes vijon me Fazën e Zhvillimit dhe Prodhimit inxhinierik, faza e prodhimit dhe zhvillimit, e cila mbyllet me sistemin e blerjes dhe e fundit është qëndrueshmëria operacionale dhe faza e mbështetjes. Procesi i planifikimit të logjistikës së blerjes përfshin një rishikim të aftësive të sistemit dhe analizën e çështjeve dhe shqetësimeve të besueshmërisë, mirëmbajtjes dhe mbështetjes së sistemit ekzistues.

Si përfundim mund të themi se perspektiva e së ardhmes për logjistikën e integruar në botën e biznesit po shfaqet si një mundësi kyçe e suksesit të biznesit në shoqërinë moderne. Ndërsa kompanitë por edhe Forcat e Armatosura përpigën vazhdimisht të përmirësojnë operacionet dhe të përmbushin pritshmëritë e klientëve, zbatimi efektiv i logjistikës në fund po bëhet një diferencues kryesor. Aftësia për të përqafuar inovacionin teknologjik, për t’iu përgjigjur sfidave mjedisore, për t’u përqendruar në përvojën e klientit dhe për të nxitur bashkëpunimin global po vendoset si një element kyç i strategjisë së biznesit që ndihmon organizatat jo vetëm të mbijetojnë, por të lulëzojnë në një mjedis dinamik biznesi.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Përgjatë itinerarit të jetës sonë, ne përballemi me situata dhe njerëz që nuk njohin skrupuj, narcistë delirantë që veç unit të tyre dhe makutërisë nuk njohin vlera dhe ndjenja solide, siç është dhe një prej më të rëndësishmeve ndjesi humane, mirënjohja.

Mirënjohja, vlerë në zhdukje

Mirënjohja po e humbet forcën e saj, atë vlerë prej së cilës kemi përftuar shumë në të qenit Njeri sot. Sepse mirënjohja nuk është thjesht një akt falënderimi, por mbi të gjitha mirësjelljeje. Për shkak të nxitimit apo mungesës së vëmendjes, por edhe më shumë se kaq, cinizmit duke përdorur rrengje për të përfituar, harrojmë ose injorojmë atë që është e vlefshme.

Ndryshimet reflektohen dukshëm në shoqërinë e sotme. Dukshëm në ambiente të ngushta, marrëdhënie në komunitet, punë... e më gjerë se kaq në rrjetet sociale. Nis nga përdorimi i një gjuhe tejet të dëmshme, e cila reflekton gjithashtu një ndalesë kulturore. E këtu nuk përjashtohet as emancipimi, një tjetër vlerë që për shkak të rendjes së një modernizimi pa krye, cenohet dhe fundoset çdo ditë.

Po humbasim një varg cilësish të kultivuara herët, mirënjohjen, të ndërtuara mbi ndjenjat bazë që sjellin ngrohtësi, afritet, mbështetje, dashuri dhe lumturi.

Është mirënjohja ajo që na jep një shkëndijë lumturie, një plotësi e madhe që ka të bëjë më të ndjerit i përmbushur. Edhe lumturia është faktor, aq sa mungesa e saj të të tjetërsojë si individ, e kjo ka si pasojë mungesën e mirënjohjes. Në jetën e përditshme duket se është shndërruar në një fenomen. Nuk ka takt në të shprehurit apo të kërkuarit të asaj që të takon. Ka ndryshuar forma e shprehjes së etikës, sjelljes. Ka vulgaritet që në mënyrën e të menduarit. Ka shumë që, pasi ia hedhin lumit, pengesave apo vështirësive me të cilat jeta i ka përballur, e harrojnë shumë shpejt ‘Dorën që i dha mundësinë për t’u ngritur, ringritur...’. Ka nga ata që guxojnë deri aty sa, mbi parimet dhe fjalorin tënd, të të kundërvihet e të të bëjë leksione moralizmesh shoqërore apo profesionale. Shkurt, të të japë mend kur vetë nuk e kanë sasinë e duhur të lëndës. Ka nga ata që thyjnë çdo normë shoqërore, sepse realiteti i ndërtuar nga duart e veta nuk i përmbush, se zgjedhjet e bëra i kanë rezultuar fataliste dhe i duket se e gjitha bota është kundra tij.

Meskinët mirënjohjen e shohin si nënshtrim

Mirënjohja nuk është nënshtrim, është ‘akt’, është altruizëm kur dikush, qenie hyjnojë a tokësore në qoftë ai, të ndihmon pa interes, pikërisht atëherë kur nuk e ke veten në dorë.

Mirënjohja është në nderin e atij që çliron atë dhe nuk e mban të ndrydhur e ngujuar. Pakënaqësitë po e dobësojnë çdo ditë mirënjohjen.

Të jesh mirënjohës është më shumë se një formë edukimi, është një mënyrë për të kapërcyer kufijtë dhe për të arritur një dimension më emocional, personal dhe madje edhe shpirtëror.

Ndaj, pse të mos jemi mirënjohës për jetën që na është dhënë? Pse të mos jemi mirënjohës për çfarë na rrethon? Pse të mos jemi mirënjohës edhe për ata që i kanë këto karakteristika? Dhe përsëri, pse të mos falënderojmë veten për integritetin, guximin dhe forcën tonë?

Të qenit mirënjohës do të thotë të njohësh, të veprosh me përulësi dhe pa mjeshtëri, të mësosh të vlerësosh atë që është vërtet e rëndësishme në jetë.

Populli shqiptar ndër breza ka treguar mençuri të lindur e të kultivuar siç janë fjalët e urta si melhem për plagët, ku për të

“Mosmirënjohja, thelbi i poshtërsisë”



përcaktuar këtë anti-vlerë njerëzore të cilën e paskëshim pasur mes nesh në të gjitha kohërat ka thënë: “Të zëntë sytë bukë e shkalur”. Mosmirënjohja është bijë e krenarisë dhe është një nga mëkatet më të mëdha që ekzistojnë në botë. Nëse do të njohësh karakterin e dikujt vendosi në provë mirënjohjen. Sjellja jonë e mirë është provë për ta, teston shpirtin e tyre dhe na tregon në fund sesa të aftë janë njerëzit për të qenë mirënjohës. Mosmirënjohja është përfaqësimi më i dështuar i vetes!



MIRËNJOHJA PO E HUMBET FORCËN E SAJ, ATË VLERË PREJ SË CILËS KEMI PËRFTUAR SHUMË NË TË QENIT NJERI SOT. SEPSE MIRËNJOHJA NUK ËSHTË THJESHT NJË AKT FALËNDERIMI, POR MBI TË GJITHA MIRËSJELLJEJE. PËR SHKAK TË NXITIMIT APO MUNGESËS SË VËMENDJES, POR EDHE MË SHUMË SE KAQ, CINIZMIT DUKE PËRDORUR RRENGJE PËR TË PËRFITUAR, HARROJMË OSE INJOROJMË ATË QË ËSHTË E VLEFSHME.

9 shtator 1996, misioni i parë i FARSH-së në Bosnje-Hercegovinë

Në kuadër të angazhimeve politike të Republikës së Shqipërisë në luftë kundër terrorizmit, Forcat e Armatosura janë angazhuar dhe marrin pjesë aktive në operacione ndërkombëtare, në misione të ndryshme jashtë vendit, si pjesë e pandarë e operacioneve të drejtuara nga NATO, BE, OKB dhe koalicionet e përbashkëta të partnerëve tanë strategjike.

Më 9 shtator 1996, FARSH-të kanë filluar misionin e parë në Bosnje-Hercegovinë. Numri i trupave pjesëmarrëse në Operacionet e Mbështetjes së Paqes (OMP) është rritur, ashtu siç është rritur edhe gjeografikisht numri i vendeve apo rajoneve ku ato kanë kryer operacione.

Pjesëmarrja e FARSH-së në misione paqeruajtëse dhe luftarake buron nga misioni kushtetues i FARSH-së dhe baza ligjore e përcaktuar për secilin kontribut në misione paqeruajtëse apo luftarake.

Kontribute të FARSH-së, në operacione ushtarake të drejtuara nga NATO, BE dhe OKB, nga muaji shtator i vitit 1996 dhe deri në muajin dhjetor 2023 janë gjithsej me 8622 ushtarakë.

Ndër vite rreth 100 femra kanë qenë pjesë e kontingjenteve pjesëmarrëse në misione dhe operacione ndërkombëtare. Shqipëria konsiderohet si vendi i dytë në NATO për sa i përket numrit të ushtarakëve të dislokuar në misione, në raport me personelin aktiv të Forcave të Armatosura.

Bosnje-Hercegovinë, Angazhimi dhe pjesëmarrja e FARSH-së në misione paqeruajtëse

Sipas burimeve të Ministrisë të Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, kontingjenti i parë i FARSH-së, u angazhua më 9 shtator 1996 dhe vazhdoi deri në dhjetor 2007, gjithsej 21 kontingjente, ku janë angazhuar 1348 ushtarakë. Në prill 2008, në kuadër të operacionit ALTHEA, të kryesuar nga Bashkimi Evropian, vendi ynë ka dërguar në Bosnje-Hercegovinë, një grup AEM (EOD) me 13 ushtarakë, nga të cilët një përfaqësues në Shtabin e EUFOR, gjithsej në këtë mision kanë marrë pjesë 114 vetë.

Kontributi i Forcave të Armatosura, nga viti 1996 dhe deri më sot, në Bosnje - Hercegovinë, është 1473 ushtarakë. Aktualisht vazhdon angazhimi, në bazë rotacioni, me 1 përfaqësues në shtabin e EUFOR, në operacionin ushtarak të BE “ALTHEA”. Kontingjentet e FA-së morën pjesë në operacionet IFOR dhe SFOR të drejtuara nga NATO dhe operacionin ALTHEA, komanda EUFOR, drejtuar nga BE.

Në shtator - dhjetor 1996, në NATO Implementation Force (IFOR) ishin 37 ushtarakë. Në janar 1997, nëntor 2004, NATO, Stabilization Force (SFOR), 815 ushtarakë. nëntor 2004 - dhjetor 2007, kohë në të cilën misioni përfundoi me sukses detyrën në Bosnje-Hercegovinë, në kuadër të operacionit të ALTHEA, të kryesuar nga Bashkimi Evropian, me 420 ushtarakë.

Gjithsej 21 kontingjente (nga 1 - 4 me 37 ushtarakë dhe nga 5 - 21 me 71 ushtarakë), ku janë angazhuar 1348 ushtarakë në detyra sigurie dhe ruajtje baze, duke qenë në vartësi operacionale dhe në mbështetje të realizimit të detyrave paqeruajtëse të komandës gjermane. Gjithashtu në kuadër të operacionit ALTHEA, të kryesuar nga BE, vendi ynë ka dërguar në Bosnje-Hercegovinë, një grup AEM (EOD) me 13 ushtarakë (nga të cilët një përfaqësues në Shtabin e EUFOR), në prill 2008, në interes të Shtabit të EUFOR.

Kontingjentet AEM (EOD) 1-6 janë të përbërë nga 12 vetë specialistë të armatim-municioneve dhe një oficer, përfaqësues i lartë i palës shqiptare me detyrë oficer shtabi për operacionet në J3 - EUFOR.

Kontingjentet AEM (EOD) 7-8 janë të përbërë nga 10 veta EOD plus 1 përfaqësues në shtab, në total 11 ushtarakë. Kontingjentet AEM (EOD) 9-10 janë të përbërë nga 6 veta EOD plus 1 përfaqësues në shtab, në total 7 ushtarakë. Gjithsej në këtë mision kanë marrë pjesë 114 vetë.

Kontributi i Forcave të Armatosura, nga viti 1996 dhe deri më sot, në Bosnje - Hercegovinë, është 1473 ushtarakë.

Aktualisht vazhdon angazhimi, në bazë rotacioni, me 1 (një) përfaqësues në shtabin e EUFOR, në operacionin ushtarak të BE “ALTHEA”.

Bosnje-Hercegovinë, misioni i parë i madh, paqeruajtës i NATO-s

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë gjatë fillimit të viteve 1990, Bosnje-Hercegovina multi-etnike u hodh në një konflikt të përgjakshëm dhe të zgjatur. Sulmet e para serbe në vitin 1992 goditën shumicën e boshnjakëve. Vrasje, përdhunime dhe dëbime u kryen nga forcat serbe për “të pastruar” territoret e pushtuara. Banorë që jetonin nën bombardime, vetëm me energji elektrike sporadike, në të ftohtin e dimrit madje edhe në vështirësi për t’u ushqyer dhe me dhjetëra familjarë të tyre të dashur të vvarë. Pasditja e 21 nëntorit 1995, do të përhapte nëpër rrugët e mbuluara me dëborë të Sarajevës, lajmin e marrëveshjes së paqes të arritur në Dejton, Ohajo. Janë 29 vjet që nga fillimi i operacionit të parë paqeruajtës të aleancës. Forca e Zbatimit (IFOR), e udhëhequr nga NATO, u vendos në Bosnjë-Hercegovinë, më 20 dhjetor 1995, pas negociatave të suksesshme të marrëveshjes së paqes të Dejtonit.

Angazhimi i NATO-s në Bosnje-Hercegovinë mbetet i paprekur edhe sot. “Ne erdhëm për të ndihmuar sigurimin e paqes në fund të një konflikti të tmerrshëm. Sot, Bosnje-Hercegovina është një vend shumë i ndryshëm, paqësor, i qëndrueshëm dhe duke ecur drejt një të ardhme më të mirë në rrugën drejt integritimeve euro-atlantike”, - ka thënë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. “Ne kërkojmë një Ballkan Perëndimor ku njerëzit të jenë në gjendje të jetojnë si fqinjë, në paqe dhe me

respektimin e të drejtave të të gjitha komuniteteve”.

Misioni i IFOR filloi pas përfundimit të luftës në Bosnje-Hercegovinë, më 21 nëntor 1995, pas arritjes së marrëveshjes së paqes në një bazë të forcave ajrore amerikane në Dejton, Ohajo. Një muaj më vonë, më 20 dhjetor 1995, trupat nën misionin IFOR, udhëhequr nga NATO u vendosën në Bosnje-Hercegovinë për të zbatuar marrëveshjen. Ky ishte operacioni i parë i NATO-s në një vend jashtë territorit të aleancës. Në kulmin e tij, IFOR përbëhej nga 60 000 trupa të nxjerra nga vendet aleate dhe vendet partnere, përfshirë edhe nga Rusia. IFOR operoi sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, nga i cili rrjedh mandati i tij, nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Detyra kryesore IFOR-it ishte për të ruajtur paqen dhe për të veçuar Forcat e Armatosura të Federatës së Bosnje-Hercegovinës nga ato të Republikës Srpska. IFOR gjithashtu mbikëqyri demarkacionin e vijave kufizuese dhe heqjen e armëve të rënda. Operacioni IFOR u zëvendësua në dhjetor të vitit 1996 nga Forca Stabilizuese, e udhëhequr nga NATO, (SFOR), e cila ishte më e vogël në madhësi dhe që kishte një mandat tjetër. Në vitin 2004, BE mori përsipër rolin e stabilizimit. NATO ofroi planifikim dhe mbështetje logjistike në përpunje me marrëveshjet Berlin Plus, rënë dakord midis dy organizatave. NATO mban një shtab në Sarajevë që i ofron këshilla Bosnje-Hercegovinës në reformën e mbrojtjes, koordinon aktivitetet e partneritetit dhe mbështet përpjekjet e vendit në integrimin euro-atlantik. Bosnje-Hercegovina u bë vend partner i NATO-s në vitin 2006 dhe është aplikant për anëtarësim në NATO. Integrimi në BE është një nga objektivat kryesore politike të Bosnjë-Hercegovinës, ajo ka iniciuar procesin e Stabilizim Asociimit në vitin 2007.

Qëllimi dhe zbatimi i IFOR dhe SFOR

Forca e Zbatimit (IFOR) u vendos në Bosnje-Hercegovinë në dhjetor 1995 me një mandat njëvjeçar. IFOR operoi sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB-së, që rrodhi autoritetin e tij nga Rezoluta e OKB-së Këshillit të Sigurimit (RKSKB) 1031 të 15 dhjetorit 1995. Kjo i dha një mandat jo vetëm për të ruajtur paqen, por edhe, kur është e nevojshme, për të zbatuar atë. Si i tillë dhe në mënyrë rigorozë, IFOR ishte një operacion i zbatimit të paqes, që ishte më zakonisht i referuar si një operacion i mbështetjes së paqes. IFOR-i synoi të mbikëqyri zbatimin e aspekteve ushtarake të Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit, marrëveshja i dha fund luftës në Bosnjë. Detyra kryesore ishte për të garantuar fundin e armiqësive dhe të ndante Forcat e Armatosura të Federatës së Bosnje-Hercegovinës, nga njëra anë, dhe të Republikës Srpska, në anën tjetër. IFOR mbikëqyri transferimin e territorit në mes të Federatës së Bosnje-Hercegovinës dhe Republikës Srpska, demarkacionin e kufirit ndërmjet entiteteve dhe heqjen e armëve të rënda në zonat e miratuara. Ndërsa situata në terren ishte përmirësuar, IFOR filloi ofrimin e mbështetjes për organizatat e përfshira në mbikëqyrjen e zbatimit të aspekteve civile të Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit, duke përfshirë Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë, të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe Kombeve të Bashkuara.

Ndërsa situata ishte ende potencialisht e paqëndrueshme dhe shumë aspekte të tjera kishin mbetur për t’u realizuar në anën civile, NATO ra dakord për të vendosur një forcë të re Stabilizuese (SFOR) që nga dhjetori i 1996. Forca e Stabilizimit (SFOR) operoi sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB-së, që rrjedh autoritetin e saj nga

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1088 të datës 12 dhjetor 1996. Siç ishte rasti për IFOR-in, ky ishte një operacion i zbatimit të paqes që ishte më zakonisht i referuar si një operacion në mbështetje të paqes. Detyra kryesore e SFOR-it ishte që të kontribuonte për një ambient të qetë dhe të sigurt të favorshëm për rindërtimin civil dhe politik. Në mënyrë të veçantë, SFOR kishte për detyrë të pengonte ose parandalonte rifillimin e armiqësive; për të promovuar një klimë në të cilën procesi i paqes mund të vazhdonte për të ecur përpara; dhe, për të siguruar mbështetje selektive brenda mjeteve dhe aftësive të organizatave civile të përfshira në këtë proces të saj. Aktivitetet për të shkonin nga patrullimi dhe ofrimi i sigurisë në zonën përmes reformës së mbrojtjes mbështetjen dhe mbikëqyrjen e operacioneve të çminimit, për të arrestuar individët e paditur për krime lufte dhe ndihmuar kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre.

Gjatë këtyre misionëve, një total prej 36 vendesh aleate dhe partnere kontribuuan me trupa. Përveç kësaj, ushtarë nga pesë vende që nuk ishin as anëtarë të NATO-s dhe as vende partnere morën pjesë në kohë të ndryshme, siç ishin Argjentina, Australia, Kili, Malajzia dhe Zelande e Re. IFOR, forcë prej 60 000 trupash u vendos për një vit kurse SFOR, fillimisht përbëhej nga 31 000 trupa, deri në fillim të vitit 2001 u reduktua në 19 000, në pranverën e vitit 2002 u mor vendimi për zvogëlimin e trupave në 12 000 deri në fund të vitit 2002, dhe në vitin 2004 arriti në 7 000 trupa.

Në dhjetor 2004, përgjegjësia kryesore për aspektet ushtarake të Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit iu dorëzua BE-së, i cili që atëherë po kryen operacionin e EUFOR-it “Althea” në Bosnje-Hercegovinë. NATO i ofron mbështetje EUFOR Operacionit “Althea” sipas Marrëveshjeve të Berlin Plus. Bosnje-Hercegovina iu bashkua programit të Partneritetit për Paqe (PfP) në vitin 2006. Më pas u ftua t’i bashkohej Planit të Veprimit të Anëtarësimit (MAP) në vitin 2010, një program i NATO-s me këshilla, asistencë dhe mbështetje praktike të përshtatur për nevojat individuale të vendeve që dëshirojnë të bashkohen me Aleancën. Pjesëmarrja në MAP nuk paragjykon asnjë vendim për anëtarësimin e ardhshëm. Vendi duhet të vazhdojë të ndjekë reformat demokratike dhe të mbrojtjes për të përmbyshur aspiratat e tij euro-atlantike.

Për këtë qëllim, nën MAP, Bosnje-Hercegovina prezantoi Programin e saj të parë të Reformës në vitin 2019. Ky program përshkruan reformat që qeveria synon të ndërmarrë dhe lehtëson ofrimin e mbështetjes nga NATO ndaj këtyre përpjekjeve. Në fillim të vitit 2021, Bosnje-Hercegovina themeloi Komisionin për Bashkëpunim me NATO-n, i cili koordinon zbatimin e aktiviteteteve reformuese në kuadër të Programit të Reformës.

Në dritën e pushtimit të plotë të Rusisë në Ukrainë në vitin 2022, NATO po rrit mbështetjen e saj për partnerët, përfshirë Bosnje-Hercegovinën, për t’i ndihmuar ata të ndërtojnë aftësitë e tyre dhe të forcojnë qëndrueshmërinë e tyre. Ministri i Mbrojtjes i Bosnje-Hercegovinës mori pjesë në Samitin e NATO-s 2022 në Madrid. Gjatë këtij samiti, aleatët ranë dakord për një sërë masash shtesë politike dhe praktike për të mbështetur vendin në forcimin e qëndrueshmërisë së tij, duke përfshirë zhvillimin e një pakete të re për Ndërtimin e Kapaciteteve Mbrojtëse (DCB). Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s miratuan paketën e re të DCB-së për Bosnje-Hercegovinën në shkurt 2023.



Gruaja-Shenjt, misionarja shqiptare me gjurmë të artë në histori

Shën Tereza është shqiptarja më e ndritur, e cila me përdëllimin e saj karshi mjerimit, urrejtjes, individualizmit dhe indiferencës, krijoi një qiellnajë shpirtërore të dashurisë, solidaritetit dhe përkushtimit.

Nga porositë e panumërta dhe të paçmuara që Nënë Tereza, kjo luftëtare e urtë e paqes, pa mjete dhune, i la njerëzimit sot, në këtë botë të trazuar, të rrezikuar nga retë e luftës, kam zgjedhur mësimin e madhërishtëm: “Nuk kemi nevojë për armë dhe bomba për të sjellë paqe në botë, kemi nevojë për dashuri, mëshirë dhe dhembshuri”.

Anjezë Gonxhe Bojaxhiu (zyrtarisht Mary Theresa Bojaxhi, Shkup, 26 gusht 1910 – Kalkutë, 5 shtator 1997), e njohur si Nënë Tereza e Kalkutës (dhe e nderuar në kishën katolike si Shën Tereza e Kalkutës), ishte një murgeshë dhe misionare katolike indiane me prejardhje shqiptare. U lind në Shkup, asokohe qendra e Vilajetit të Kosovës në Perandorinë Osmane. Jetoj në vendlindje për tetëmbëdhjetë vjet, ajo u shpërngul në Irlandë dhe më pas në Indi, ku jetoj pjesën më të madhe të jetës së saj.

Nënë Tereza themeloi Misionarët e Bamirësisë, një kongregacion katolik, i cili në vitin 2012 kishte më shumë se 4 500 motra dhe ishte aktiv në 133 shtete. Ato ofrojnë shtëpi për njerëzit që janë duke vdekur nga HIV/AIDS, lebra dhe tuberkulozi; ato ofrojnë ushqime, klinika të lëvizshme, programe këshilluese për fëmijët dhe familjet, jetimore, dhe shkolla. Anëtarët duhet t'i përmbahen betimit të “dëlirësisë, varfërisë dhe bindjes”, si dhe një kusht të katërt, për të dhënë “shërbime falas e me gjithë zemër për më të varfrit e të varfërve”.

Nënë Tereza ishte një tregtare e njohur. Ishte bashkëpronare e një firme ndërtimi në Shkup. Kompania e saj bëri bashkëfinancimin e projektit për ndërtimin e teatrit të parë të Shkupit. Ajo mori pjesë në zhvillimin e linjës hekurudhore që e lidh Kosovën me Shkupin, projekt që e kishte financiar personalisht. Nënë Tereza tregonte se ishte shumë krenare që familja e saj asnjëherë nuk e la dikë me dorë ose me zemër të zbrazët. Ajo disa herë e vizitoi edhe Kosovën. Çdo kund u admirua për veprat e saj bamirëse.

Nënë Tereza është nderuar me çmimet dhe nderimet më të larta, duke përfshirë, më 1962 Çmimin e Paqes “Ramon Magsaysay” dhe 1979 Çmimin “Nobel” për Paqe.



Më 19 tetor 2003, ajo u lumturua dhe u quajt “Tereza e Bekuar e Kalkutës”. Për t'u kanonizuar në shenjto, asaj duhej t'i njihej një mrekulli e dytë, në bazë të rregullave të kishës katolike. Një mrekulli e dytë i është njohur nga Papa Françesku, në dhjetor të vitit 2015, duke i hapur rrugën që ajo të shpallet e shenjt nga Kisha Katolike e Romës.

Kanonizimi i saj është bërë, më 4 shtator 2016, një ditë para 19-vjetorit të vdekjes së saj (5 Shtator), ku njihet edhe si dita e saj e festës.

Një figurë e diskutueshme si gjatë jetës dhe pas vdekjes së saj, Nënë Tereza u admirua gjerësisht nga shumë njerëz për veprat e saj bamirëse. Ajo u vlerësua dhe u kritikua për akuzat të ndryshme, të tilla si për pikëpamjet e saj për abortin dhe kontracsionin.

Më 10 shtator 1946, Tereza përjetoi atë që ajo e përshkroi më vonë si “thirrje brenda thirrjes”, kur udhëtoi me tren për në manastirin Loreto në Darjeeling nga Kalkuta për tërheqjen e saj vjetore. “Unë do të largohesha nga manastiri dhe t'i ndihmoja të varfrit ndërsa jetonim në mesin e tyre. Ishte një urdhër. Të dështosh do të ishte të prishësh besimin”. Joseph Langford më vonë shkroi, “Megjithëse askush nuk e dinte atë kohë, Motra Terezë sapo ishte bërë Nënë Tereza”.

Ajo filloi punën misionare me të varfrit në 1948, duke zëvendësuar zakonet e saj tradicional Loreto me një sari të thjeshtë

pambuku të bardhë me një kontur blu. Teresa mori nënshtetësinë indiane, kaloi disa muaj në Patna për të marrë trajnim bazë mjekësor në Spitalin e Familjes së Shenjtë dhe u fut në lagjet e varfra. Ajo themeloi një shkollë në Motijhil, Kalkuta, para se të fillonte të kujdeset për të varfrit dhe të uriturit. Në fillim të vitit 1949 Tereza u bashkua në përpjekjet e saj nga një grup i grave të reja dhe ajo hodhi themelet për një bashkësi të re fetare, duke ndihmuar “më të varfrit midis të varfërve”.

Përpjekjet e saj shpejt tërhoqën vëmendjen e zyrtarëve indianë, përfshirë kryeministrin. Teresa shkroi në ditarin e saj, se viti i saj i parë ishte i mbushur me vështirësi. Pa të ardhura, ajo lypte për ushqime dhe furnizime dhe përjetoi dyshim, vetminë dhe tundimin për t'u kthyer në komoditetin e jetës së manastirit gjatë këtyre muajve të hershëm.

“Zoti ynë dëshiron që unë të jem një murgeshë e lirë e mbuluar me varfërinë e kryqit. Sot, mësova një mësim të mirë. Varfëria e të varfërve duhet të jetë aq e vështirë për ta. Ndërsa kërkoja një shtëpi, unë eca dhe eca derisa mu acaruan krahët dhe këmbët. Mendova se sa duhet të dhembim në trup dhe shpirt, duke kërkuar shtëpi, ushqim dhe shëndet. Pastaj, komoditeti i Loreto-s (ish-kongregacioni i saj) erdhi për të më tunduar”. “Ju duhet të thoni vetëm fjalën dhe gjithçka që do të jetë përsëri e juaja”, vazhdoi të thotë Tempter. ... “Me zgjedhjen e lirë, Perëndia im, dhe nga dashuria për ju, unë dëshiroj të qëndroj dhe të bëj çfarëdo që të jetë vullneti juaj i Shenjtë në lidhje me mua. Nuk e lëshova një lot të vetëm”.

Në 1952, Tereza hapi bujtinën e saj të parë me ndihmën e zyrtarëve të Kalkutës. Ajo shndërroi një tempull Hindu të

braktisur në Shtëpinë Kalighat për Vdekjen, falas për të varfrit, dhe e quajti atë Kalighat, Shtëpia e Zemrës së Pastër (Nirmal Hriday). Ata që u sollën në shtëpi morën kujdes mjekësor dhe mundësinë për të vdekur me dinjitet në përputhje me besimin e tyre: Myslimanëve iu lexua Kurani, hindusët morën ujë nga Ganga dhe katolikët morën vajosje ekstreme. “Një vdekje e bukur, - tha Tereza, - është për njerëzit që kanë jetuar si kafshë të vdesin si engjëj - të dashur dhe të kërkuar”.

“Nirmal Hriday”, bujtina e Kalkutës së Nënë Terezës, në 2007 Ajo hapi një bujtinë për ata me lebër, duke e quajtur atë “Shanti Nagar” (Qyteti i Paqes). Misionarët e Bamirësisë krijuan klinika për shtrimin e të sëmurëve me lebër në të gjithë Kalkutën, duke siguruar ilaçe, veshje dhe ushqim. Misionarët e Bamirësisë morën një numër gjithnjë e më të madh të fëmijëve të pastrehë. Në vitin

1955 Tereza hapi “Nirmala Shishu Bhavan” - “Shtëpia e Fëmijëve të Zemrës së Papërlyer”, si një strehë për jetimet dhe rininë e pastrehë.

Tereza tha: “Me anë të gjakut, unë jam Shqiptare. Nga nënshtetësia, një indiane. Me anë të besimit, unë jam një murgeshë katolike. Sa i përket thirrjes sime, unë i përkas botës. Sa i përket zemrës time, unë i përkas plotësisht zemrës së Jezusit”.

Ajo fliste rrjedhshëm pesë gjuhë Bengalisht, Shqip, Serbisht, Anglisht dhe Hindisht. Ajo bëri udhëtime të rastit jashtë Indisë për arsye humanitare.

Në kulmin e Rrethimit të Bejrutit, në 1982, Tereza shpëtoi 37 fëmijë të bllokuar në një spital të linjës së përparme, duke ndërmjetësuar një armëpushim të përkohshëm midis ushtrisë izraelite dhe guerileve palestinezë. E shoqëruar nga punëtorët e Kryqit të Kuq, ajo udhëtoi nëpër zonën e luftës për në spital për të evakuuar pacientët e rinj.



Misioni i (pa) mundur i Paqes me Terroristët dhe Putinistët?!



GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ:
EKSPERT PËR SK, RAJONIN DHE NATO-n

Në “kapacitetin e Ekspertit të Sigurisë Kombëtare, Rajonit dhe NATO-s”, vijoj të ndjek (24/7), me përgjegjësi të shtuar luftën “për/me Ukrainën” si dhe përballjen e Izraelit me një valë të re të përshkallëzimit të sigurisë në Lindjen e Mesme mbas masakrës së organizatës terroriste të Hamasit, më 7 tetor 2023.

Paraprakisht, më duhet të qartësoj edhe më fort se, për sa trajtoj në këtë opinion, si edhe në çdo rast tjetër, nuk kanë të aspak të bëjnë me paragjyime mbi përkatësinë fetare, etnike, politike, gjinore dhe ngjyre, por as me të drejtën sovranë të vetëmbrojtjes së identitetit kombëtar, integritetit territorial; mbi të gjitha kurrësi me jetët e qytetarëve të pafajshëm (që vuajnë pasojat e ndërmarrjeve terroriste, neonaziste, neostaliniste, apo çdo forme tjetër të ekstremizmit dhe dhunës barbare), qofshin, Palestinezë, Izraelitë, Arabë, Rus, Ukrainas dhe çdo vendi tjetër të përfshirë në konflikte të armatosura.

Për t’u rikthyer subjektit të këtij opinion, sjell në vëmendje një listë të historisë së konflikteve Izraelito - Arabe: “Rrënjët i ka në “Palestinën historike”, në fundin e shekullit të 19-të, kur “Sionizmi” i Theodor Herzl, projektoi Atdheun Hebre në Palestinë. Në 1948, David Ben-Gurion shpalli themelimin e Shtetit të Izraelit (u njoh nga OKB, më 11 maj 1949), por edhe nisjen e Luftës I Arabo-Izraelite.

Në 1956, gjatë krizës së Suezit, Izraeli me Mbretërinë e Bashkuar e pushtuan Egjiptin por nga presioni ndërkombëtar u tërhoqën. Në luftën 6 ditore (1967), Izraeli pushtoi Gadishullin Sinai, Bregut Perëndimor dhe Rripin e Gazës. Në vitin 1973, Egjipti dhe Siria sulmuan Izraelin gjatë festës së hebrevë të YomKipurit, por Izraeli i zmbrapsi dhe mori më shumë territore. Marrëveshja e Camp David (1978) e ndërmjetësuar nga SHBA-të, i normalizoi marrëdhëniet mes Izraelit me Egjiptit. 1987, kryengritjet palestineze shënuan Intifadën e parë. 1993, Negociatat e Oslos, themeluan Autoritetin Palestinez; Samiti i Camp David (2000); Konferenca e Annapolis (2007), Marrëveshja e Abrahamit (2020), etj.”, që gjithsesi nuk kanë prodhuar paqe të qëndrueshme!

Ndërsa posaçërisht në këtë artikull, do përpiqem të hedh më shumë dritë rreth riciklimit të konfliktit “pas 7 tetorit 2023” ose: “përmbledhje të përditësuar me mësimet e nxjerra nga përballja jo vetëm e Izraelit me organizatat dhe shtetet terroriste; sfidat, impaktet dhe rekomandimet strategjike për (pa) mundësinë e ndërtimit të paqes në Lindjen e Mesme si dhe impaktet mbi Ballkanin Perëndimor”. Më konkretisht: Rreth 50 mijë të vrarë dhe mbi 100 mijë të plagosur; mijëra raketa, avionë luftarak dhe dronë vrasës, miliona refugjatë në portat e perëndimit si dhe trilionë € shpenzime. Një kosto shumë e lartë, kështu edhe një mision pothuaj i pamundur për të bërë një përmbledhje ngushëlluese për jetët e humbura (qytetarë të pafajshëm Palestinezë dhe Izraelitë) si dhe të solidaritetit “kundër/pro luftës”, ndaj ekstremizmit të çdo forme.

Siç dihet, vala e re e konfliktit, nisi më 7 tetor 2023, kur më shumë se 2500 paramilitarë të Hamasit (shpallur organizatë



terroriste nga SHBA-të dhe BE-ja) sulmuan Izraelin; ndërsa mbi 3000 raketa u hodhën nga Rripi i Gazës, duke masakruar mbi 1200 qytetarë në një festë publike; morën si barbarë pengje 250 pleq/gjyshër, gra dhe vajza (gjysma ende të pa dorëzuar), si dhe vijnë të përdorin si barrikada (ç) njerëzore bashkëqytetarë palestinezë!

Konflikti u zgjerua, me përfshirjen “de fakto” të Iranit, mbrëmjen e së premtes datë 13/14 prill 2024, kur një shi me 300 raketa vrasëse goditën brutalisht (fatmirësisht pa sukses) hapësirën ajrore të Izraelit: “si hakmarrje ndaj sulmit ajror të 1 prillit 2024”, në konsullatën iraniane Damask, ku mbeti i vrarë gjenerali Mohammad Zahedi, komandant i lartë i Gardës së Iranit (IRGC). Po ashtu për vrasjen e liderit politik të Hamasit, Ismail Haniyeh, gjatë një sulmi ajror në Teheran, Irani fajësoi “pa asnjë provë” Izraelin, dhe kështu të 2 sulmet, i konsideroi si: “shkelje të sovranitetit të Iranit”.

Situata u përkeqësua, me përfshirjen e grupit të armatosur Hezbollah, në vrasjen e 12 fëmijëve nga një sulm me raketa, më 28 korrik 2024, në një fushë futbolli në lartësitë e Golanit. Si përgjigje shpagueuse nga sulmet ajrore të izraelit në Bejrut, më 31 korrik 2024, mbeti i vrarë Foud Shukur, ndër themeluesit e Hezbollahut. Ndërsa si kundërpërgjigje për vrasjen e ushtarakut të lartë, grupi Hezbollah (ndër të tjera akte terroriste në bashkërendim me Hamasin), më 25 gusht 2025, goditi Izraelin me mbi 320 Raketa Katyusha (ruse), duke e imponuar Qeverinë e Netanyahu të ndërmarrë një fushatë ajrore ndëshkuese dhe shkatërrimtare ndaj shtabeve, armatimit dhe infrastrukturave kritike të Hezbollahut.

6 mësimet e nxjerra nga përballja e mbas 7 tetorit 2023

1: Duke tejkaluar propagandën cinike, më duhet ta përsëris edhe më fort se përtej rrethanave specifike që i janë imponuar Izraelit për mbijetesë: “ushtrimi i të drejtës së hakmarrjes proporcionale, ndaj shteteve apo organizatave terroriste”, mbetet edhe si një sfidë e përbotshme, pasi: “nëse terroristët e Hamasit, Hezbollahut, apo Shtetit Islamik të Iranit, do të gjunjëzonin (në mos shfarosnin nga faqja e dheut) Izraelin, nuk do krijonte kjo një precedent fatal për paqen, sistemin e sigurisë globale si dhe vlerat e qytetërimit në mbarë botën?! Për më qartë, për këdo egocentrik mendjendryshkur, por ndoshta të mirë paguar, pyetja mbetet: “nëse do gjunjëzohej kështu edhe Uashingtoni, Londra, Berlini, Parisi, Roma, Kievi dhe çdo vend tjetër ndaj organizatave terroriste, çfarë pasojash katastrofike do të kishte kjo mbi rendin global, shoqërinë

njerëzore, harmoninë fetare, bashkëjetesën paqësore, etj.”?! Parë nga ky këndvështrim, luftën e imponuar të Izraelit kundër terroristëve e gjej: jo vetëm në të drejtën sovranë të mbijetesës, por edhe si kontribut shtesë për vlerat demokratike si dhe interesat euroatlantike!

2: Nga kjo përballje e imponuar ushtarake përgjatë 11 muajve të fundit, u testuan dhe sprovuan aftësitë e pathyeshme dhe shkatërrimtare të mbrojtjes ajrore të Izraelit, si dhe besimi te fuqia e pamposhtur e flotës ajrore të SHBA-ve dhe MB-së, ndaj sulmeve të Hamasit, Shtetit Islamik të Iranit, Hezbollah, etj.

Gjithsesi, mesazhi përbashkët i listës së pas-konflikteve të sipërpërmendura mbetet: “në të gjitha konfliktet, përfshi dhe rastin e fundit, Izraeli me mbështetjen e aleatëve strategjike (SHBA/MB/BE), jo vetëm ka triumfuar por edhe ka zgjeruar territorin, pozitrat strategjike si dhe peshën gjeopolitike në Lindjen e Mesme”.

Kështu edhe përballja e suksesshme e Izraelit përgjatë 11 muajve të fundit (duke asgjësuar mbi 97 % të raketave dhe dronëve vrasës), shërben edhe si një mesazh force edhe ndaj Putinit, që: “nëse do të guxonte të sulmonte qoftë edhe 1metër² të cilido nga 32 vendet anëtare të NATO-s do të mposhtej dhe poshtërohej nga fuqia e pakonkurrueshme e Aleancës Euroatlantike (SHBA/NATO/MB/BE)”. Ky mesazh force qëndron edhe për ish-ministrin e Millosheviçit dhe ushtarin e bindur të Kremlinit (z. Vuçiç), që: “të mos armatohet me Avionë luftarakë sulmues (18 “Mig-29” apo “12 Rafale” = mbi 6 miliardë €), raketa, etj., duke harxhuar kot së koti mbi 1.5 miliard € në vit nga mendi i popullit serb. Kjo pasi asnjë nga vendet e rajonit nuk kërcënon Serbinë, por edhe Ajo s’ka këllqe për t’u përballur me aftësitë mbrojtëse të Kosovës (p.sh pajisjen e FSK-së nga SHBA-të me 246 raketa “Javelin”) dhe as me fuqinë e sprovuar (1999) ushtarake të Aleancës Euroatlantike”.

3: Solidariteti dhe kohezioni diplomatik, demonstruar në terren “konfirmon me vepra” mbështetjen pa kompromis të Izraelit në luftën kundër terrorizmit, si “kërcënim dhe e keqe përbashkët”.

Ndërsa prezenca e dy luftaniëve ushtarake të SHBA-së, MB-së, etj., në rajon konfirmon mbështetjen pa kompromis të Izraelit edhe për shkak të një lobi të fortë Izraelit në vendimmarrjet e Uashingtonit dhe Londrës. Për marrëdhëniet SHBA-Izrael kam edhe një koment shtesë: “shumica



dërrmuese e 195 shteteve të OKB-së (përfshi Kosovën) e kanë vetëshpallur SHBA-në aleat strategjik, ndërsa Izraeli dhe Islanda mbeten ndër të vetmet shtete të konfirmuara kështu nga Uashingtoni Zyrtar”. Si shembull përmendim se paketa e ndihmës ushtarake të SHBA-së ndaj Izraelit (1948 – 2024) arrin në 150 miliardë dollarë, ose sa 100 vjet shpenzime ushtarake të Hamas dhe Hezbollah së bashku!

4: Nga kjo luftë ndaj terrorizmit u vetë-demaskuan edhe vendet që mbështetën boshtin e së keqes (Hamas - Iran - Hezbollah), si Rusia-Putiniste - Koreja e Kim Jong-ut - Dodikët mëndje-ndryshkur në Ballkanin perëndimor. Prandaj ky mësim (nr.4), mbart edhe një mesazh mbi domosdoshmërinë kritike, për të bashkëpunuar në rrafshin global dhe rajonal në luftën me rreziqet e përbashkëta, pra shtetet, diktaturat neo-staliniste apo organizatat terroriste të sipërpërmendura.

Nga ana tjetër, sulmet terroriste të 7 tetorit 2023, apo 14 prillit dhe 25 gushtit 2024, kundër një vendi sovran/Izraelit si dhe jetës së popullsisë civile edhe nëse nuk janë planëzuar “drejtpërdrejt nga Kremli”, është e sigurt, që i shërbejnë përpjekjeve të dëshpëruara të Putinit, për të hapur një front të ri lufte krahas asaj në Ukrainë. Por, do të dështojë me turp, ashtu si edhe në përpjekjen për ta tërhequr Kinën në luftë me Tajvanin; apo për ta frymëzuar Beogradin deri në aventurën e “ri-pushtimit ushtarak të Republikës së Kosovës, edhe pse prej 1990 ajo mbetet nën prezencën/ përgjegjësinë e trupave të KFOR-it”!

5: Përtej mendjeve të deformuara në Teheran, Kremlin, Korenë e Veriut, (përfshi në Ballkan), duke u përpjekur t’i japin dimension fetar apo “legjitimuar” sulmet barbare të Hamasit, Iranit, Hezbollahut, jo vetëm kundër Izraelit, kurrsesi nuk kanë të përbashkët me vlerat e fesë Islame.

Po ashtu përtej emërtimeve patriotiko-fetare, HAMAS (Lëvizja e Rezistencës Islamike), apo Hezbollah (Partia e Zotit/Allahut), “terroristët e pa Fe” që çirren si monstra: “Allāhu ʾakbar” ose “Zoti është i madh” edhe pasi masakrojnë barbarisht qytetarë dhe u presin kokat fëmijëve të pafajshëm;



VALA E RE E KONFLIKTIT, NISI MË 7 TETOR 2023, KUR MË SHUMË SE 2500 PARAMILITARË TË HAMASIT (SHPALLUR ORGANIZATË TERRORISTE NGA SHBA-TË DHE BE-JA) SULMUAN IZRAELIN; NDËRSA MBI 3000 RAKETA U HODHËN NGA RRIPI I GAZËS, DUKE MASAKRUAR MBI 1200 QYTETARË NË NJË FESTË PUBLIKE; MORËN SI BARBARË PENGJE 250 PLEQ/GJYSHËR, GRA DHE VAJZA (GJYSMA ENDE TË PA DORËZUAR), SI DHE VIJOJNË TË PËRDORIN SI BARRIKADA (Ç) NJERËZORE BASHKËQYTETARË PALESTINEZË!

kur marrin zvarrë pengje pleq/gjyshër, gra dhe vajza, vrasin me bomba/raketa kamikaze mijëra qytetarë të pafajshëm, apo edhe kur përdorin si barrikada (ç) njerëzore bashkëqytetarë Palestinezë nga Rripi i Gazës”, kurrsesi nuk kanë të përbashkët me kuranin dhe as me vlerat e fesë Islame!

Në të kundërt, frymëzuesit që fshihen si minj në transhetë e Rripit të Gazës, e keqpërdorin fenë për axhendën e tyre politike. Ndërsa është i mirënjohur fakti që ashtu si edhe besimet e tjera

komplementare, edhe feja Islame mbjell paqe, tolerancë, mirëkuptim, bashkëjetesë paqësore, etj.

6: Pikërisht për të prevaluar me masat diplomatike për zgjidhjen e konfliktit, OKB, SHBA, MB, NATO dhe BE, i kanë adresuar “mesazhe të ashpra” edhe Qeverisë Demokratike të Izraelit, që: “të vetëpërmbahet në ushtrimin e drejtës reciproke si dhe të përshkallëzuar të shpagimit, duke shmangur në maksimumin e mundshëm pasojat mbi popullsinë e pafajshme civile”. Kjo mbetet një “këshillë çarmatosëse për propagandistët e Teheranit, Kremlin, etj.”, që i cilësojnë sulmet ajrore të Izraelit si: “fashiste”. Pikërisht për këtë, z. Netanyahu ka konfirmuar se “Izraeli do të vijojë sulme shkatërruese ajrore, por të kufizuara si dhe të preçuara vetëm ndaj infrastrukturave kritike/ushtarake”. Ndërsa qendra e gravitetit të sulmeve të Izraelit, mbetet ndaj terroristëve të pa fe (Hamasit, Iranit, Hezbollahut, etj.) që vijojnë të kërcënojnë jo vetëm “mbijetesën e identitetit kombëtar të Izraelit”, por janë përgjegjës edhe për aktet çnjerëzore dhe jetët e qytetarëve të pafajshëm të Izraelit dhe Palestinës!

Rekomandime për zgjidhjen e konfliktit dhe ndërtimin e bashkëjetesës paqësore në Lindjen e Mesme:

Sigurisht, Izraeli ka fuqi ushtarake dhe aleanca të qëndrueshme për të “mposhtur shtetet apo grupet terroriste”, ose në rast agresioni për t’u përballur dhe mundur të gjitha vendet Arabe së bashku. Por për të mbjellë klimën e paqes afatgjatë mes popullit Izraelit dhe Palestinez do duhet të prevalojnë mekanizmat e diplomacisë si dhe një akt historik falje mes Izraelit dhe vendeve të rajonit, të shoqëruar nga një “road-map” ose një paketë gjithëpërfshirëse masash për të mbjellë klimën e mirëbesimit reciprok ndërmjet popujve të rajonit, de-militarizimin, balancat e fuqisë ushtarake, bashkëpunimi ekonomik, kulturor, etj., ndërsa aktorët ndërkombëtarë, SHBA, OKB, NATO, BE do duhet të vijojnë të mbajnë peshë thelbësore.

Nga ana tjetër, historitë e pas-luftërave na mësojnë se rrugëtimi drejt paqes afatgjatë, kërkon vizion, lidership, përkushtim dhe kompromise të mëdha. Siç e sipër përmendëm, konflikti Izraelito-Arab mbetet një çështje komplekse, e shtrirë në dekada dhe që përfshin një mori faktorësh historikë, fetarë, kulturore, territorialë, identitetin kombëtar, interesa gjeopolitike, ekonomike, etj., qe nuk mund të zgjidhen si me magji “brenda një nate dhe as njëherësh”!

Për më tepër nuk ma lejon as, grada e lartë ushtarake - gjeneral (R), por as eksperiencia në NATO të bëjë “moralizime populiste” mbi detyrimet kushtetuese të Forcave të Armatosura si dhe as më pak ta paragjykojë të drejtën sovranë që ka Izraeli të përdorë në mënyrë të përshkallëzuar fuqinë ushtarake për mbijetesën e identitetit kombëtar dhe mbrojtjen e integritetit territorial si dhe garantimin e jetës qytetarëve Izraelit, por edhe kontributet për mbrojtjen e vlerave demokratike të njerëzimit si dhe interesat e aleancës euroatlantike.

Sigurisht duhet vetëpërmbytje, vijimi i aktiviteteve diplomatike dhe respektimi i konventave ndërkombëtare, duke përdorur armë me precizon të lartë kundër Hamasit, Iranit dhe Hezbollah; duke hapur korridore humanitare dhe mjekësore për popullsinë palestineze si dhe duke shmangur në maksimumin e mundshëm viktima të pafajshme (megjithëse 100 % është mision i pamundur).

Për më tej, për të krijuar frymën e mirëbesimit do duhet një akt faljeje, si dhe një marrëveshje paqe me faktorët lokalë të moderuar që zgjidhjen e konfliktit dhe bashkëjetesën paqësore nuk e gjejnë nëpërmjet akteve terroriste. Ndërsa, frymëzuesit dhe terroristët do duhet të çohen para drejtësisë ndërkombëtare për krime kundër njerëzimit. Thënë këto, në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk do të duhet të ndalen përpjekjet diplomatike nga Izraeli, vendet Arabe dhe komuniteti ndërkombëtar.

Më duhet ta përsëris edhe më fort se për një paqe të qëndrueshme dhe afatgjatë, domosdoshmërisht do duhet të prevalojnë mekanizmat diplomatike mes Izraelit, Palestinës dhe vendeve të tjera arabe, të përfshira në konfliktin. Një zgjidhje e diskutuar gjerësisht mbetet rikthimi te projekti i dy shteteve sovranë (Izraelit dhe Palestinës), që do duhet të përfshijë negociatat për kufijtë, refugjatët dhe Jerusalemin si kryeqytet i përbashkët, si dhe një paketë masash të mirëbesimit reciprok përfshi de-militarizimin, balancat e fuqisë ushtarake; lirinë e të burgosurve, bashkëpunimin ekonomik, shkëmbimet kulturore, etj. Sigurisht, aktorët ndërkombëtarë, OKB, SHBA, BE dhe ata rajonalë, kanë një rol thelbësor për paqe të qëndrueshme.

FORUMI STRATEGJIK I BLED, SLLOVENI

Von der Leyen: Ne duam një Evropë të fortë, konkurruese dhe të sigurt, kjo përfshin Ballkanin Perëndimor

U zhvillua Forumi Strategjik i Bled-it në Slloveni, ku i pranishëm ishte edhe kryeministri i Shqipërisë z. Edi Rama, i cili shoqërohej nga ministri i Jashtëm, Igli Hasani. Në këtë Forum, Kosova u përfaqësua nga ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla si dhe ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli.

Ngjarja ka për qëllim të ofrojë një mundësi për liderët politikë, akademikë dhe ekspertë të diskutojnë dhe të gjejnë zgjidhje për çështje strategjike dhe globale. Gjatë fjalës së tij, kryeministri Rama ndër të tjera solli në vëmendje konfliktin në Ukrainë, ku tha se Putin ishte ai që bëri BE-në të kuptojë se i duhet Ballkani Perëndimor, gjë të cilën e tha edhe lideri kroat. Kryeministri në forumin e Bled-it në Slloveni ka shprehur sërish qëndrimin e tij krah Ukrainës në luftën e saj me Rusinë. Ai tha se është jashtë realitetit që një vend në Europë të ndryshojë kufijtë me forcë.

Presidentja von der Leyen, gjatë fjalës së mbajtur në Forumin Strategjik të Bled, i cili këtë vit mban titullin “Një botë e realiteteve paralele”, shqyrtoi kthesën e jashtëzakonshme dhe përparimin e arritur në politikën e zgjerimit të BE-së gjatë mandatit të saj aktual si Presidente e Komisionit.

Presidentja von der Leyen foli se si integrimi i mëtejshëm i jep BE-së më shumë levë dhe një zë më të fortë në botën e sotme të fragmentuar. Presidentja tha se: “një treg i vetëm më i madh rrit konkurrencën tonë dhe fuqinë tonë si partner tregtar. Na jep mjetet për t’iu përgjigjur shantazheve dhe konkurrencës së pandershme. Dhe kjo na jep fuqi më të madhe blerëse të përbashkët. Zgjerimi është një investim në forcën dhe sigurinë tonë kolektive. Me fjalë të tjera: Ne duam një Evropë të fortë, konkurruese dhe të sigurt, kjo përfshin Ballkanin Perëndimor, si dhe Ukrainën dhe Moldavinë në Bashkimin tonë Evropian dhe të gjithë ata, aspiratat evropiane të të cilëve përputhen me veprat e tyre. Kjo është arsyeja pse ne i kemi futur një jetë të re procesit të zgjerimit. Ka pasur hapa të rëndësishëm në procesin e integrimit në BE. Negociatat e anëtarësimit u nisën me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Moldavinë dhe Ukrainën. Presidentja gjithashtu shprehu besimin e saj se Bosnje-Hercegovina mund të jetë e radhës.

Ishte ky arsyetim strategjik që na nxiti të rimendonim strategjitë tona të zgjerimit dhe të dilnim me idenë e një integrimi gradual. Pikërisht një vit më parë, ne lançuam Planin e ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor. Dhe kjo punë ka filluar të tregojë rezultate. Le të ndalemi për një moment dhe të festojmë këto arritje për të cilat ju, liderët e Ballkanit Perëndimor, me të drejtë duhet të jeni shumë krenarë. Tirana është aeroporti me rritjen më të shpejtë në Evropë. Kompanitë evropiane po hapin dyqane në Serbi dhe Bosnje Hercegovinë me një ritëm të përshpejtuar. Reformat ekonomike të Kosovës janë paralajmëruar nga FMN dhe po sjellin përfitime ekonomike. Investimet e Maqedonisë së Veriut në infrastrukturë janë burim frymëzimi. Mali i Zi sapo ka parë të përmirësuar vlerësimin e tij të kreditit në bazë të politikave të tij të shëndosha. Deri në fund të vitit, tre prej jush tashmë mund t’i bashkohen Zonës sonë të vetme të pagesave në euro. Kjo do të gjenerojë mbi 500 milionë euro kursime çdo vit, pasi të jeni të gjithë brenda”.

Veçanërisht, Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor, i paraqitur nga Komisioni vitin e kaluar, tashmë po jep rezultate konkrete në terren. Më vonë këtë muaj, gjashtë partnerët e Ballkanit Perëndimor do të miratojnë Axhendën e tyre të Reformës, e cila përmban reforma specifike, thelbësore, të lidhura me 6 miliardë euro investime evropiane. Siç theksoi presidentja von der Leyen, çdo reformë do të hapë investime të reja.

Presidentja vuri në dukje se sipas Planit të Rritjes, pasi të jenë vendosur të gjitha reformat, çdo partner i Ballkanit Perëndimor do të ketë marrë përafërsisht aq shumë ndihmë për frymë sa do të merrte sipas politikës së kohezionit të BE-së.

Presidentja e Komisionit vuri në dukje se në Kolegjin e saj të ri do të emërojnë një Komisioner të përkushtuar për Zgjerimin dhe përfundoi duke kujtuar se zgjedhjet e vështira mbeten përpara: “Mosmarrëveshjet dypalëshe duhet të trajtohen. Integrimi në Bashkimin Evropian do të varet nga qeveritë, duke marrë vendime të vështira dhe, po, ndonjëherë jopopullore.



Shtyrja e vendimeve do të thotë të marrësh vendime të gabuara. Por të marrësh vendime, të ecësh përpara, do të thotë të marrësh drejtimin, të formësosh të ardhmen tonë, të jesh zotërues i fatit tonë”.

Çfarë është Forumi Strategjik Bled?

Forumit Strategjik Bled është një platformë globale për gjenerimin e ideve dhe shkëmbimin e pikëpamjeve mbi shoqërinë bashkëkohore dhe të ardhmen e saj. Ajo është e përkushtuar për të krijuar një botë të qëndrueshme duke ofruar pikëpamje dhe zgjidhje strategjike për çështjet më urgjente të së sotmes dhe të së nesërme.

Si një platformë gjithëpërfshirjeje dhe diversiteti, ajo përqipet të bashkojë sa më shumë aktorë të ndryshëm dhe të shpërndajë pikëpamjet e tyre përmes ngjarjeve, diskutimeve, tryezave të

rrumbullakëta, projekteve, analizave dhe publikimeve.

Ngjarja e saj qendrore vjetore - konferenca ndërkombëtare e Forumit Strategjik të Bled - është konferenca kryesore në Evropën Qendrore dhe Juglindore, e cila u zhvillua në fund të gushtit në mjedisin piktoresk alpin të liqenit Bled, Slloveni. Konferenca është një mbledhje e pjesëmarrësve nga fusha të ndryshme me njohuri të ndryshme, duke i inkurajuar ata të shkëmbejnë pikëpamje dhe të gjenerojnë ide për të adresuar sfidat e tanishme dhe të ardhshme. Përveç kësaj, konferenca ofron gjithashtu një mundësi unike për takime të përshtatura dhe rrjetëzim me palët e interesuara rajonale dhe globale.


Forumit Strategjik Bled është një projekt ndërqeveritar i Republikës së Sllovenisë.



Makinat me levitacion magnetik të Japonisë revolucionarizojnë industrinë e automobilave

Japonia, e njohur për risitë e saj teknologjike, është në prag të revolucionit në industrinë e automobilave me zhvillimin e makinave me levitacion magnetik (maglev). Kjo teknologji novatore, e krijuar nga studiuesit në Institutin e Shkencës dhe Teknologjisë në Okinawa (OIST), ka potencialin për të eliminuar motorët dhe bateritë tradicionale, duke ofruar një vështrim futuristik në të ardhmen e transportit.

Shkenca prapa levitacionit magnetik



Levitacioni magnetik, ose maglev, është një metodë me të cilën një objekt qëndron pezull në ajër, duke përdorur fusha magnetike, duke eliminuar nevojën për kontakt fizik me një sipërfaqe. Kjo teknologji redukton në mënyrë drastike fërkimin, duke lejuar lëvizje më të qetë dhe më efikase. Ndërsa maglev është përdorur në trena prej vitesh, studiuesit e OIST e kanë çuar më tej konceptin duke e aplikuar atë në automjetet personale, duke transformuar potencialisht mënyrën se si ne mendojmë për makinat.

Makinat maglev të zhvilluara nga OIST ndryshojnë ndjeshëm nga trenat ekzistues maglev. Trenat tradicionalë maglev kërkojnë energji elektrike të vazhdueshme për të ruajtur fushat e tyre magnetike, por sistemi i ri i zhvilluar nga OIST kërkon energji vetëm në fillim. Pasi të krijohet fusha magnetike fillestare, makinat e bëra nga materiale diamagnetike pluskojnë mbi pistë, duke lëvizur pa pasur nevojë për energji shtesë.

Si funksionojnë makinat me levitacion magnetik

Ekipi OIST ka krijuar një sistem unik gjurmësh që përdor



magnet të rregulluar në një rrjet të vazhdueshëm nën sipërfaqe. Këta magnete ndërveprojnë me makinat e projektuara posaçërisht, të cilat janë bërë nga një përzierje e grafitit dhe dyllit të pluhurosur, duke i lejuar ato të fluturojnë disa centimetra mbi pistë. Ky konfigurim eliminon nevojën për motorë dhe bateri, duke i bërë automjetet më të lehta, më efikase ndaj energjisë dhe potencialisht më miqësore me mjedisin.

Një nga avantazhet më domethënëse të kësaj teknologjie është eliminimi pothuajse i plotë i fërkimit, një shkak kryesor i humbjes së energjisë në automjetet tradicionale. Duke hequr nevojën për motorë dhe duke reduktuar varësinë nga bateritë, makinat me levitacion magnetik mund të sjellin një epokë të re të transportit të qëndrueshëm.

Përparësitë ndaj teknologjive tradicionale

Zhvillimi i makinave maglev mund të tejkalojë teknologjitë e tjera të avancuara të automobilave që po ndiqen aktualisht nga prodhuesit kryesorë të automjeteve. Për shembull, motori me karburant të dyfishtë i Lamborghini-t, motori me djegie me emetim zero i Toyota-s dhe motorët gjermanë me emetim të ulët janë të gjithë përparime mbresëlënëse. Megjithatë, ata ende mbështeten



në një formë të shtytjes tradicionale, qoftë karburant apo energji elektrike. Në të kundërt, teknologjia e levitacionit magnetik ofron një largim të plotë nga këto sisteme, duke eliminuar potencialisht emetimet dhe duke reduktuar ndjeshëm ndikimin mjedisor të transportit.

Për më tepër, mungesa e pjesëve mekanike si motorët dhe transmisionet në makinat maglev mund të çojë në kosto më të ulëta të mirëmbajtjes dhe jetëgjatësi më të madhe të automjetit. Ky reduktim i kompleksitetit është një tjetër avantazh i mundshëm, duke i bërë këto automjete jo vetëm miqësore me mjedisin, por edhe ekonomikisht të zbatueshme në planin afatgjatë.

Sfidat dhe rruga përpara

Pavarësisht nga potenciali emocionues i makinave me levitacion magnetik, mbeten disa sfida përpara se ato të bëhen realitet për shoferët e përditshëm. Një nga çështjet kryesore është përkallëzimi i teknologjisë në një madhësi praktike të përshtatshme për prodhim masiv. Prototipi eksperimental i zhvilluar nga OIST është relativisht i vogël dhe përshtatja e teknologjisë për automjetet me madhësi të plotë do të kërkojë përparime të rëndësishme.

Një sfidë tjetër është amortizimi i vorbullës, një fenomen ku sistemet lëkundëse humbasin energjinë me kalimin e kohës për shkak të forcave të jashtme. Në makinat maglev, kjo mund të çojë në një humbje të efektit të levitacionit, duke e bërë të vështirë ruajtjen e lëvizjes së vazhdueshme dhe efikase. Studiuesit po punojnë në

mënyrë aktive për të adresuar këto çështje, por ato përfaqësojnë pengesa të rëndësishme që duhet të kapërcehen.

Më shumë për t'u marrë në konsideratë

Për më tepër, infrastruktura e nevojshme për të mbështetur makinat maglev është një tjetër konsideratë. Rrugët dhe autostradat ekzistuese nuk janë projektuar për të akomoduar fushat magnetike të nevojshme për levitacion. Zhvillimi i infrastrukturës së re ose rinovimi i atyre ekzistuese do të jetë një proces i kushtueshëm dhe kërkon kohë, por është thelbësor për miratimin e gjerë të kësaj teknologjie.

Një vështrim në të ardhmen

Teknologjia e levitacionit magnetik të Japonisë përfaqëson një hap të guximshëm përpara në evolucionin e transportit. Duke eliminuar nevojën për motorë, bateri dhe duke reduktuar fërkimin, makinat maglev mund të ndryshojnë në mënyrë drastike mënyrën se si udhëtojmë, duke e bërë transportin më të qëndrueshëm dhe efikas. Ndërkohë që mbeten sfida të rëndësishme, përfitimet e mundshme të kësaj teknologjie janë shumë më të mëdha se pengesat, duke e bërë atë një perspektivë premtuese për të ardhmen e industrisë së automobilave. Ndërsa kërkimi dhe zhvillimi vazhdojnë, së shpejti mund të shohim makina maglev që kalojnë nga prototipet eksperimentale në automjete praktike, të përditshme, duke sjellë një epokë të re transporti që mund të revolucionarizojë industrinë e automobilave siç e njohim ne.





Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

(Në kuadrin e 104-vjetorit të fitores, më 3 shtator 1920)

Thirrje për të shkuar në Vlorë

Luftimi popullor, si një nga format e luftimit, mori zhvillim me pjesëmarrjen masive të popullit në luftën çlirimtare të Vlorës, të vitit 1920 dhe të rrethinave të saj. Efektivit i forcave vullnetare erdhi duke u rritur me shpejtësi e në kohë, me vullnetarë të ardhur nga të gjitha krahinat e vendit. Kryengritja mori zhvillim dhe pjesëmarrja e popullit, i cili u ngrit në këmbë për të fituar të drejtat e tij, për liri dhe identitet. Forcat kryengritëse në fillim ishin pak. Kjo dhe për vet karakterin e luftës, e cila nuk fillon menjëherë me pjesëmarrjen e popullit, për shkak të mundësive të kufizuara të rezervave njerëzore, por dhe të aparatit mobilizues në zonë e në vend. Zyrat e rekrutimit ushtarak mungonin në të gjithë krahinën e Vlorës dhe më gjerë. Por, me çlirimin e fshatrave një pas një, u krijua mundësia e shtimit të luftëtarëve. Kryengritjen e armatosur që nisi popullsia patriotike e krahinës së Vlorës kundër pushtuesit italianë, u shndërrua shpejt në një kryengritje të të gjithë popullit shqiptar. Thirrjeve të Komitetit të “Mbrotjes Kombëtare”, për të shkuar në Vlorë iu përgjigjën shumë vullnetarë nga anë të ndryshme të vendit e sidomos nga krahinat e afërta. Kryengritësit u organizuan në çeta mbi bazë fshati, krahine e prefekturë, duke vënë në komandë njerëzit me përvojë luftarake të provuar më parë. Nën drejtimin e Komitetit të “Mbrotjes Kombëtare” u ngrit kështu një ushtri vullnetare kryengritëse, që arriti në 4.000 luftëtarë e përbërë kryesisht nga fshatarë. Por gjatë zhvillimit të kryengritjes kjo forcë arriti deri në 6.000 luftëtarë.

Ngritja dhe organizimi i komiteve

Një ndër masat përgatitore për daljen e vullnetarëve për luftë, ishte ngritja dhe organizimi i komiteve të fshehta të “Mbrotjes Kombëtare”. Të tilla me shpejtësi u krijuan në Shqipërinë e Jugut e të Mesme, më konkretisht në Vlorë, Tepelenë, Gjirokastrë, Përmet, Mallakastër, Fier, Berat, Skrapar, Pogradec, Korçë, Kolonjë, Tiranë, Elbasan, Shkodër etj. Të gjitha këto përgatitje u pasqyruan në shtypin përparimtar të kohës, si në organizimin e mitingjeve e të ndihmave të vijueshme, gjatë gjithë periudhës së luftës. Lëvizja në përkrahje të masave për luftë u zgjerua shumë gjatë muajve prill dhe maj të vitit 1920. Mitingje solidariteti dhe kërkesa e ultimatumë u bënë nga shumë qytete të vendit, ku pjesëmarrësit shprehnin gatishmërinë për ta ndihmuar nga ana materiale, por dhe për të shkuar vullnetarë në Vlorë. Në mbështetje të luftës në mjaft krahina e zona të vendit u organizuan mitingje. Në Gjirokastrë, pjesëmarrësit u shprehën se “shqiptarët dje derdhën gjakun për të huaj, dinë të derdhin gjakun edhe për veten e tyre”. Ndërsa në mitingun e organizuar nga populli i Kolonjës, u theksua se “... të gjithë jemi gati të bëhemi theror për atdheun”. Në kujtimet e mësuesit elbasanas Ahmet Gashi, drejtues i bandës “Afërdita”, theksohet se “...për 10 ditë rresht shkuam lagje më lagje e shtëpi më shtëpi të qytetit me bandën muzikore e me flamurin kombëtar për të mbledhur ndihma. Nuk mbeti shtëpi e dyqan pa na dhënë. Gjithsej u mblodhën 3000 napolona ar, të cilat ia dorëzuan Komisionit Qendror të Luftës së Vlorës. Përfaqësuesit e Komitetit të ‘Mbrotjes Kombëtare’ vunë në dijeni qeverinë e Tiranës për gatishmërinë e tyre dhe për fillimin kryengritjes. Kryeministri Sulejman Delvina dhe shumica e anëtarëve të qeverisë e pranuan gatishmërinë e tyre dhe i premtuan këtij Komiteti, kryesisht ndihma me materiale, por këto jo në rrugë zyrtare”.

Konflikti i armatosur shtrihej në Labëri

Konflikti i armatosur që po përgatitej në Vlorë shtrihej në tri zona të Labërisë si: në Vlorë, në Tepelenë dhe në Himarë. Kështu, konflikti merrte karakterin e një lufte lokale të banorëve të zonës së pushtuar nga imperialistët italianë. Hapjen e një konflikti më të madh shtetëror midis Italisë dhe Shqipërisë, qeveria e Tiranës nuk e dëshironte. Ajo nuk e përballonte jo vetëm për mungesë forcash, por dhe për pozitën e vështirë në të cilin ndodhej vendi. Qeveria e Tiranës në vijimësi njoftonte në Vlorë se, nga Tirana, Elbasani, Peqini, Kavaja e të tjera, po regjistroheshin e stërviteshin kryesisht luftëtarë, ndërsa në disa rrethe kishte filluar grumbullimi i ndihmave materiale si në Korçë, Berat, Tiranë, Shkodër e Gjirokastrë. Natyrisht, peshën më të madhe të luftës në njerëz dhe në materiale e mbajti populli patriot i krahinës së Vlorës, në



Pjesëmarrja e luftëtarëve nga vendi në Luftën e Vlorës 1920

të cilën përfshihej atëherë dhe Tepelena, Kurveleshi e Himara. Kjo është e dukshme veçanërisht në fazën e parë të veprimeve luftarake. Me kohë në Kurvelesh ishte bërë një mbledhje, ku kishin marrë pjesë të gjithë fshatrat e Labërisë, për një lëvizje kundër forcave italiane që mbanin të pushtuar Vlorën. Kështu që “ditët e fundit mësuam sigurisht që lëvizja nisi”. Për sigurimin me ushqim të çetave të Kurveleshit dhe të Tepelenës, u vendos që çdo familje të jepte 3% të sasisë së kokëve të bagëtive të tyre. Sipas vendimit të Komisionit Ushtarak të Luftës së Vlorës, fshatrat që kishin më pak se 20 luftëtarë do bashkonin me çetën e fshatit më të afërt. Në përfundim të mbledhjes u ngrit flamuri kombëtar dhe u deklarua se nuk njihej asnjë qeveri dhe se nuk pranohej të paguheshin taksat e detyrimet e vendosura nga qeveri në shërbim të pushtuesit. Çdo fshat ngriti një komision me 5-7 veta për sigurimin dhe administrimin e furnizimeve për çetat.

Gazetari italian për luftën

Luftimet për marrjen e garnizonit të Tepelenës vazhduan për dy javë, sepse trupat italiane deri dy batalioneve të këmbësorisë dhe një bateri artilerie, në pamundësi t’u qëndronin forcave kryengritëse në terren të hapur, u futën në Kalanë e qytetit. Forca kryengritëse bllokuan furnizimet përfshi furnizimin me ujë. Çetat e Kurveleshit (Golemit, Picarit, Lekdushit, Progonatit dhe Kolonjës) ishin përhapur nga ana e rrëzës së kodrave dhe sulmonin në drejtim të kalasë nga perëndimi e jugu. Më 21 qershor 1920 garnizoni u dorëzua. Gazetari italian Gustavo Tralio do të shkruante “... Tepelena, qytezë e vogël, e struktur në një kodër dhe e rrethuar nga mbeturinat e kështjellës së Ali Pashës, u pushtua nga kryengritësit, të cilët përparuan gjatë kodrave. Këtë natë kemi dëgjuar topat që gumëzhijnë. Qyteti rronte prej disa netësh në ethe të vazhdueshme, sot në mëngjes u zgjua me zhurmën e zakonshme, duke pllakosur zija nëpër rrugë”. Ndërsa një gazetë tjetër italiane do të shkruante: “Po jetojmë orë të tmerrshme. Të ngjethet mishi nga pamja e tmerruar e qytetit (Tepelenës). Disa thonë se kryengritësit janë 5.000, të tjerë thonë 10.000, po asgjë s’dihet e saktë. Është e pamundur të vërtetosh shumë e saktë të humbjeve tona”.

Vullnetarë nga të gjitha krahinat e vendit

Vullnetarë nga krahina të tjera të vendit dhe ndihma materiale

arritën në fazën e dytë të luftimeve, në kohën e rrethimit të ushtrisë italiane në qytetin e Vlorës. “... Rreth 5-6.000 shqiptarë rrethuan qytetin, por reagimi i trupave ishte i fortë dhe efikas. Situata nga dita në ditë po merrte përmasat e një lufte kombëtare për çlirimin e Shqipërisë...”. Vullnetarë dhe ndihma të tjera erdhën jo vetëm nga krahinat e afërta si: Berati e Gjirokastra, por edhe nga Korça, Elbasani, Durrësi e Tirana etj. Kontribut të shquar dhanë në Luftën e Vlorës në vitin 1920 dhe Mallakastra, Gjirokastra, Përmeti, Skrapari, Devolli, si dhe çetat e Çamërisë me Muharrem Rushitin dhe Alush Takën, çeta e Tiranës me Said Toptanin, si dhe çeta e Himarës me Nase Labin e Naqe Konomin, etj. Midis fazës së parë dhe të dytë erdhën ndihma vullnetare nga krahina Mallakastrës etj. Vullnetarë nga Tirana erdhën 200 luftëtarë, të cilët megjithëse nuk morën pjesë aktive në luftë, por për moralin ishin shumë të vlefshëm. Në luftë erdhën edhe luftëtarë nga fshatrat e Bregdetit, si nga Vunoi e Himara, si edhe nga Borshi. Fitoret e para qenë inkurajuese për forcat kryengritëse dhe shërbyen si nxitje për veprimtari më të vullshme të komiteve të ngritura në krahinat e tjera të vendit. Më tepër se 1000 vullnetarë u nisën për në front nga rrethet e Tiranës, Elbasanit, Beratit, Durrësit, Fierit, Korçës, Përmetit e Gjirokastrës. U mblodhën ndihma të shumta në të holla, veshje, sende ushqimore e armatime. Në front shkuan qindra vullnetarë të rinj nga të gjitha krahinat e vendit. Kështu, nga Gjirokastra, Korça e Çamëria mbërritën 700 vullnetarë. Çetat e Skraparit me 300 luftëtarë, të udhëhequr nga Riza Cerova e Muço Kapinova, mbërritën në Vlorë e në Tepelenë.

Pjesëmarrës në Luftën e Vlorës ishin dhe mjaft ushtarakë. Këta ndikuan në mobilizimin e njerëzve, me gjithë vështirësitë e shumta si mungesa e theksuar e rrugëve dhe mjeteve të transportit, vështirësi në furnizimin me armë dhe municione. Më tej u ndje mungesa në fuqinë dhe në dobinë e zjarrit, pra të pajisjes më armatim, përballë një kundërshtari të armatosur me mjete më të mira të kohës. Të gjitha këto u kompensuan nga epërsia e pjesëmarrjes së masave popullore në këtë luftë kryengritëse, por dhe nga udhëheqja e ushtarakëve shqiptarë, si dhe nga njohja e mirë e terrenit.



Pazari i Vjetër i Shkodrës, 'hipermarketi' mesjetar i Ballkanit

Pazari i vjetër në Shkodër në kohën e lulëzimit të tij, u bë vërtetë një qytet i madh tregtar midis pjesës së vjetër dhe asaj të re të qytetit, i shtrirë në 1.8 km gjatësi, ku vlonte tregtia dhe ku madhësia e tij lejonte të punonin dhe të blinin aty mbi 10 000 njerëz.

Ndërsa në ditët e pazarit, ditët e diela apo të mërkura, aty mund të ishin prezentë më shumë se 30 mijë vetë, çka e tregonte edhe fakti se shkodranët e kanë pasur traditë dhe janë vlerësuar si “mjeshtërit” më të shkëlqyer në tregti.

Atë kohë në breg të Liqenit dhe lumit Buna ankoroheshin dhjetëra anije të vogla e të mëdha deri te avulloret 1000 tonelata, si dhe kishte edhe një pazar anijesh që ishte në “garë” me “Pazarin e Madh”, por që ishte edhe si vazhdim i tij. Aty ishin ngritur magazina të mëdha për hyrje – dalje mallrash, kishte zyra të mëdha doganore si edhe banka dhe afër 1500 dyqane të papërsëritshme, sot e kësaj dite.

Në të djathtë të Urës së Bunës ka qenë Zyra Doganore, ku kryheshin të gjitha veprimet financiare për import/eksportet e mallrave në Shkodër.

Dyqanet ishin vendosur në mbi 30 sokakët (rrugët) e pazarit, të cilat ishin ndarë sipas zanateve (zejeve) e ku punonin disa qindra zanatçinj e çirakë që mësonin e punonin çdo ditë. Brenda Pazarit të Vjetër kishte rregull dhe disiplinë të veçantë si edhe kryheshin shërbime kafeje, berberhaneje, hekurosje etj.

Gjatë kohës së punës, tregtarët për nevojat e tyre komuniknin njëri me tjetrin me anë dritaresh të vogla dhe në fund të ditës së punës, dyqanet mbylleshin me taraba, qepena, si dhe siguroheshin me roje dhe elemente të tjerë sigurie.

Pazari i Vjetër përveç anës ndërtimore, ka qenë i sistemuar edhe në pjesën nëntokësore, e konkretisht ka pasur 5 kanale të tillë, të cilët largonin ujin nga pazari dhe ishin afër 1.8 metër të thellë. Kanali i parë mblidhte ujin e kodrave, i dyti përshkonte “sokakun e pemëshitësve”, një i tretë kalonte “skelën e peshkut”, i katërti përshkonte “sokakun e kasapëve” dhe i pesti kalonte përmes “Pazarit të madh”, por që të pesë këto kanale ujin e mbledhur e derdhnin në Bunë. Sigurisht që kanalet pastroheshin çdo vit nga punëtorë të veçantë. Pra, që në atë kohë sistemimit të pazarit i është dhënë një rëndësi e madhe si në anën ndërtimore ashtu edhe në relacion me funksionimin e plotë të tij për zhvillimin



PAZARI I VJETËR PËRVEÇ ANËS NDËRTIMORE, KA QENË I SISTEMUAR EDHE NË PJESËN NËNTOKËSORE, E KONKRETISHT KA PASUR 5 KANALE TË TILLË, TË CILËT LARGONIN UJIN NGA PAZARI DHE ISHIN AFËR 1.8 METËR TË THELLË. KANALI I PARË MBLIDHTE UJIN E KODRAVE, I DYTË PËRSHKONTE “SOKAKUN E PEMËSHITËSVE”, NJË I TRETË KALONTE “SKELEËN E PESHKUT”, I KATËRTI PËRSHKONTE “SOKAKUN E KASAPËVE” DHE I PESTI KALONTE PËRMES “PAZARIT TË MADH”, POR QË TË PESË KËTO KANALE UJIN E MBLEDHUR E DERRDHININ NË BUNË.

e tregtisë e të zejtarisë. Kështu shumë shpejt Pazari i Vjetër u bë qendra më e madhe tregtare e trevave Shqiptare e më gjerë në eksport – importin e mallrave nga Kosova, Mali i Zi, Serbia, Manastiri, Bullgaria dhe anasjelltas, pra në gjithë Rumelinë e asaj kohe. Në planin tregtar dhe financiar, Pazari i Madh në Shkodër

është vlerësuar nga të tjerët si “Hipermarketi” më i madh i asaj kohe në Ballkan, si dhe ka qenë i pakonkurrueshëm për nga madhësia, pasuritë që kishte brenda dhe kapacitetet përpunuese të mallrave, i krahasuar me pazaret e tjerë të fqinjëve tanë, çka vërteton se Shkodra ka qenë Metropoli i Arbërisë.



BËH U VERSIONI YT MË I MIRË!